# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5564
E premte, 31 gusht 2018
çmimi 0.40 €


## Thaçi rikonfirmon idenë për korrigjim të kufirit

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de




FLET PËR "EPOKËN E RE", NASER RUGOVA FAQE 4-5

# Kuvendi ta parandalojë iniciativën që rrezikon tërësinë territoriale

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Naser Rugova, ka thënë se Kuvendi duhet ta thotë fjalën e fundit lidhur me idenë për korrigjimin e kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka deklaruar se deputetët më 4 shtator duhet ta miratojnë rezolutën për ruajtjen e integritetit territorial të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Rugova ka theksuar se Kuvendi duhet të parandalojë çfarëdo iniciative që rrezikon sovranitetin dhe tërësinë territoriale të shtetit. Ai ka shprehur optimizëm se rezoluta për këtë çështje do të mbështetet nga të gjitha partitë, edhe nga ato të pushtetit. Rugova ka bërë me dije se opozita është në rrugën e duhur për t'i siguruar votat për rrëzimin e Qeverisë

# Kosova, më afër liberalizimit të vizave

FAQE 3

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Naser Rugova, ka thënë se Kuvendi duhet ta thotë fjalën e fundit lidhur me idenë për korrigjimin e kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka deklaruar se deputetët më 4 shtator duhet ta miratojnë rezolutën për ruajtjen e integritetit territorial të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Rugova ka theksuar se Kuvendi duhet të parandalojë çfarëdo iniciative që rrezikon sovranitetin dhe tërësinë territoriale të shtetit. Ai ka shprehur optimizëm se rezoluta për këtë çështje do të mbështetet nga të gjitha partitë, edhe nga ato të pushtetit. Rugova ka bërë me dije se opozita është në rrugën e duhur për t'i siguruar votat për rrëzimin e Qeverisë






## Kërkohet të rritet presioni ndaj Serbisë për të zhdukurit

FAQE 6

## AKTUALE

### I KUJT DO TË JETË SHTATORI?

F. 11



Nga Bedri ISLAMI

### DREJTORITË KOMUNALE TË ARSIMIT, TË GATSHME PËR FILLIMIN E VITIT TË RI SHKOLLOR F. 6

### EDITA TAHIRI: KUVENDI KA PËRGJEGJËSINË HISTORIKE T'I THOTË JO NDRYSHIMIT TË KUFIJVE F. 7

### KLINIKA OBSTETRIKE GJINEKOLOGJIKE FURNIZOHET ME PAJISJE MODERNE F. 6

## EKONOMI

### KËSHILLI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT: VENDIMI I ZRRE-SË, JOLIGJOR DHE ZHVATËS F. 8

### PRISHTINA SUBVENCIONOI ME 140 000 EURO BLEGTORËT DHE ME 50 000 EURO BLETARËT F. 8

## KULTURË

### DITARI I PROFESORIT F.13

Shkruan: Ismail SYLA

## SPORT

### UEFA LICENCON STADIUMIN "FADIL VOKRRI", KOSOVA DEBUTON MË 10 SHTATOR F. 18

### DY GRUPE TË "VDEKJES" NË LIGËN E KAMPIONËVE F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Mogherini: Ballkani Perëndimor, partner ushtarak i NATO-s

VJENË, 30 GUSHT - Vendet e Ballkanit Perëndimor po bëhen partnerë të sigurisë së Bashkimit Evropian, deklaroi të enjten shefja e diplomacisë së Bashkimit Evropian, Federica Mogherini. Deklarata e zyrtares së lartë evropiane u bë gjatë takimit jozyrtar të ministrave të Mbrojtjes së BE-së. "Diplomatët diskutuan në këtë takim bashkëpunimin në fushën e sigurisë me vendet e Ballkanit Perëndimor. Ballkani Perëndimor është konsideruar gjithmonë në zonë destabiliteti, ndërkohë që tani BE-ja i konsideron ato vende partnere", theksoi Mogherini. BE-ja po diskuton me NATO-n përmirësimin e bashkëpunimit për sigurinë në rajon", shtoi ajo. Ministrat e Unionit do të fokusohen edhe mbi mundësitë e zgjerimit të programit evropian të Bashkëpunimit të Përhershëm Strukturor (PESCO) për sigurinë dhe mbrojtjen.



# Koalicion i gjerë i partive në mbështetje të referendumit në Maqedoni

Koalicioni i gjerë i partive politike që udhëhiqet nga Lidhja Socialdemokrate (LSDM) e kryeministrit Zoran Zaev ka vendosur ta mbështesë referendumin në Maqedoni që do të mbahet më 30 shtator

SHKUP, 30 GUSHT - Rreth 30 parti politike kanë formuar koalicionin për mbështetje të referendumit në Maqedoni që do të mbahet më 30 shtator. Ky koalicion udhëhiqet nga Lidhja Socialdemokrate (LSDM) e kryeministrit Zoran Zaev, ndërsa bën pjesë edhe Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), Partia Demokratike Shqiptare (PDSH), Lëvizja Besa dhe të gjitha partitë e tjera të koalicionit qeveritar, por edhe parti të tjetra jashtëparlamentare. Koalicioni ka vendosur që përmes fushatës, tribunave dhe aktiviteteve të tjera t'i nxisë qytetarët që të dalin dhe të votojnë "për" në referendumin e ardhshëm për marrëveshjen për emrin me Greqinë. "Marrëveshja hap dyert e Maqedonisë për anëtarësim në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Partitë konsiderojnë se çdo qytetar i Republikës së Maqedonisë me të drejtë vote duhet ta marrë përgjegjësinë, të dalë dhe të votojë 'për' referendumin e ardhshëm", thuhet në komunikatën e publikuar pas takimit të mbajtur të mërkurën në mbrëmje. "Suksesi i referendumit do të thotë ndërtimi i një Maqedonie evropiane. Jam i bindur se shumica e qytetarëve që ne përfaqësojmë dhe që na kanë besuar përgjegjësinë për ta udhëhequr vendin, do ta përmbushin detyrën e tyre qytetare, do të dalin në referendum dhe do të votojnë për Maqedoninë evropiane", ka deklaruar lideri i LSDM-së, njëherësh kryeministër i Maqedonisë, Zoran Zaev.

Në takim nuk ka marrë pjesë Aleanca për Shqiptarët që është parti opozitare, por kjo parti më herët ka bërë të ditur se mbështet referendumin, por në fazën e ndryshimeve kushtetuese që pasojnë pas referendumit, do t'i paraqesë disa kërkesa për rregullimin e statusit të gjuhës shqipe në Kushtetutë si dhe për bartjen e sovranitetit të shtetit te të gjitha bashkësitë etnike.


Official website

Ndërkohë, VMRO-DPMNE-ja, si partia më e madhe e opozitës maqedonase, ende nuk ka dalë me qëndrimin final, përveç që ka refuzuar mjetet e ndara nga Kuvendi për zhvillimin e fushatës për referendumin.

Ndërsa referendumin po e mbështesin Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Zyrtarë të lartë të BE-së do të jenë pjesë e fushatës dhe tribunave të ndryshme që do të organizohen për sensibilizimin e qytetarëve për të votuar në mbështetje të referendumit.

# Ahmeti: Nuk ka vend për kalkulime



Shkup, 30 gusht - Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, deklaroi të enjten se referendumi i 30 shtatorit është një rast për të dëshmuar se e ardhmja e integrimit euroatlantik të Maqedonisë është në duart e qytetarëve të saj. Ai tha se koha për lidership është tani dhe e ardhmja e përbashkët dhe e ndritur është në duart e tyre, dhe se me rrethim të opsionit "për" më 30 shtator vulosin të ardhmen e vendit. "Qytetarët dhe forcat progresive në vend tashmë janë të bindur se integrimi në NATO dhe në BE sjell paqe të qëndrueshme, stabilitet dhe siguri, barazi dhe marrëdhënie të shëndosha ndëretnike, mirëqenie shoqërore dhe zhvillim ekonomik", tha ai.

Ahmeti i ka bërë thirrje opozitës të dalë në referendum për emrin dhe të ardhmen euroatlantike, pasi nga kjo përfitojnë të gjithë. "Referendumi i 30 shtatorit është referendum për ta integruar Maqedoninë në NATO dhe BE, andaj ka vetëm dy opsione, për Maqedoninë evropiane ose kundër. Unë jam i bindur se shumica dërrmuese e qytetarëve janë për Evropë dhe NATO, andaj nuk ka vend për kalkulime", tha Ahmeti.

## Ambasada e ShBA-së dënon sulmin ndaj gazetares Lala

Tiranë, 30 gusht - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka dënuar sulmin ndaj gazetares hulumtuese Klodiana Lala dhe familjes së saj.

Në një komunikatë për mediat, ambasada thekson se gazetarja ka rol të rëndësishëm në mbulimin e reformës në drejtësi.

Sulmin me armë ndaj gazetares ambasada e cilëson akt frikacak që tregon se kriminelët kanë frikë nga drejtësia e vërtetë shqiptare. "Ambasada e Shteteve të Bashkuara dënon sulmin ndaj gazetares Klodiana Lala dhe familjes së saj. Ne nxisim autoritetet shqiptare të kryejnë një hetim tërësor dhe transparent për t'i nxjerrë autorët përpara drejtësisë. Si gazetare, Klodiana ka luajtur rol të rëndësishëm në mbulimin e reformës në drejtësi, çështjeve të gjyqësorit dhe veprimtarisë kriminale. Fakti që ajo u vu në shënjestër demonstron rëndësinë e punës së saj - sjelljen e të vërtetës te populli shqiptar. Një media e pavarur është frymëmarrja e një demokracie të fortë. Akte frikacake si ky tregojnë se kriminelët kanë frikë sa më shumë Shqipëria i afrohet një drejtësie të



vërtetë", thuhet në reagimin e Ambasadës Amerikane në Tiranë.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Komiteti i Lirive Civile i Parlamentit Evropian (LIBE) ka votuar pro liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës

# Kosova, më afër liberalizimit të vizave

**Me 30 vota për, 10 kundër dhe dy abstenime, Komiteti për Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme, i njohur si LIBE, ka votuar pro liberalizimit të vizave për Kosovën. Këtë vendim Parlamenti Evropian do ta miratojë në një seancë e cila pritet të mbahet në muajin shtator, ndërsa vendimin përfundimtar për këtë proces do ta marrë Këshilli i Ministrave i BE-së. Ky vendim është mirëpritur nga zyrtarët e lartë të BE-së dhe të Kosovës, duke u cilësuar si hap i madh përpara drejt lëvizjes së lirë**



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

**Prishtinë, 30 gusht** - Komiteti për Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme, i njohur si LIBE, ka votuar të enjten në favor të nisjes së negociatave me Këshillin Evropian dhe Komisionin Evropian për liberalizimin e vizave të qytetarëve të Kosovës. Me 30 vota për, 10 kundër dhe dy abstenime, LIBE ka votuar pro liberalizimit të vizave për Kosovën. Ky proces do të vazhdojë në seancën plenare të Parlamentit Evropian që pritet të mbahet në mesin e shtatorit të këtij viti, pastaj në Këshillin e Ministrave. Vendimi pozitiv i LIBE-s është mirëpritur nga zyrtarët e lartë të BE-së dhe të Kosovës, duke u cilësuar si një hap më pranë liberalizimit të vizave.

Komisionari për Punë të Brendshme i Bashkimit Evropian (BE), Dimitris Avramopoulos, në llogarinë e vet në "Twitter" ka shkruar se momenti i lëvizjes së lirë do të vijë shpejt. "Kosovës i është dhënë drita e gjelbër për fillimin e negociatave për liberalizimin e vizave. Shpresoj se ky moment do të vijë shumë shpejt për gjithë Ballkanin Perëndimor", ka shkuar Avramopoulosi.

Raportuesja për liberalizimin e vizave për Kosovën në Parlamentin Evropian, Tanja Fajon, ka thënë se pret që shpejt qytetarët e Kosovës të mund të udhëtojnë pa viza në shtetet e BE-së. "Jam shumë e lumtur sot, sepse është një hap shumë i rëndësishëm për Kosovën. Ka qenë një proces mjaft i gjatë dhe kërkues. Dhe e di si raportuese se sa vështirë ka qenë për kosovarët t'i arrijnë reformat e nevojshme. Standardet e vendosur ishin pak më të larta sesa për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor", ka thënë Fajon në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë".

Ajo ka bërë me dije se më nuk ka asnjë arsye të vonohet ky proces. "Në fund, patjetër se është vendim politik dhe ne të gjithë e dimë se nëse ka vullnet politik ky proces do të përfundoj shpejt. Ata nuk kanë asnjë arsye ta kundërshtojnë këtë, sepse Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret dhe kjo nuk po bëhet për njerëzit në Kosovë që tashmë mund të udhëtojnë: biznesmenët, politikanët, apo kriminelët. Këto janë kategori të njerëzve që tashmë udhëtojnë. Ne po e bëjmë këtë për njerëzit e zakonshëm, për të rinjtë, për ata që po poshtërohen para konsullatave, sepse nuk mund të udhëtojnë në vende evropiane", ka thënë ajo.

Edhe raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian, Igor Sholtes, ka uruar qytetarët e Kosovës për vendimin e LIBE-s. "Jam shumë i kënaqur me vendimin e sotëm në Komitetin e LIBE që tregon qartë se ka vullnet politik në Parlamentin Evropian për ta mbështetur Kosovën në rrugën e saj për regjimin pa viza. Rezultati i sotëm është një hap i madh përpara drejt lirisë së lëvizjes, që është një nga parimet themelore të BE-së. Shpresoj se udhëtimi pa viza së shpejti do të bëhet realitet për qytetarët e Kosovës", ka thënë ai.

Sholtes ka thënë se janë edhe disa hapa të rëndësishëm përpara në këtë proces. "Së pari, mandati duhet të konfirmohet në seancën plenare nga Parlamenti Evropian dhe pres që kjo të bëhet me shpejtësi. Votimi vendimtar do të jetë në Këshill. Unë sinqerisht shpresoj se vendet anëtare do ta ndjekin shembullin e Parlamentit Evropian dhe Komisionit Evropian. Është koha që qytetarët e Kosovës t'i gëzojnë të njëjtat mundësi dhe të marrin trajtimin e njëjtë si fqinjët e saj. Kjo nuk duhet të shtyhet tani kur është vërtetuar se kërkesat janë plotësuar, gjithashtu edhe me komitetin LIBE sot që dha dritën jeshile", ka thënë Sholtesi.

Ndërsa liderët institucionalë e kanë vlerësuar të drejtë votimin e komitetit të LIBE-s. "Komiteti për Liritë Qytetare, Drejtësi dhe Çështje të Brendshme në Parlamentin Evropian sot ka marrë një vendim tepër të drejtë, duke votuar pro liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Çdoherë e më shumë po i afrohemi vendimit final, që t'u hiqet çdo pengesë e lëvizjes së lirë edhe qytetarëve tanë në Zonën Shengen", ka shkruar Thaçi në profilin e vet në "Facebook".

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka përshëndetur votimin pro liberalizimit të vizave të Komitetit LIBE, duke thënë se ky është një lajm i mirëpritur për qytetarët. "Komisioni LIBE ka votuar pro liberalizimit të vizave. Ky është një lajm i merituar për qytetarët dhe një hap drejt vendimit final nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Ministrave i BE-së. Kosova i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe presim që brenda këtij viti qytetarët tanë të lëvizin pa viza në Zonën Shengen", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurse kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova ka bërë punë të madhe për këtë ditë. "Pas plotësimit të të gjitha kushteve për liberalizim, hapi i dytë drejt heqjes së regjimit të vizave për qytetarët e Kosovës u mbyll me sukses. Parlamenti Evropian, respektivisht Komiteti LIBE për të Drejta Civile, Drejtësi dhe Çështje të Brendshme, aprovoi sot mandatin për hapjen e negociatave me Komisionin Evropian për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës. Kosova ka bërë punë të madhe, veçanërisht për fuqizimin e sundimit të ligjit, andaj është e sigurt se do të përmbyllet me sukses i tërë procesi, duke u mundësuar qytetarëve tanë të lëvizin lirshëm në vendet e BE-së", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Qytetarët i kanë uruar edhe zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli dhe Fatmir Limaj. "Urime Kosovë! Edhe një hap më afër. Komiteti për Liritë Qytetare, Drejtësi dhe Çështje të Brendshme -LIBE, në Parlamentin Evropian ka votuar pro liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Mbetet edhe sfida e fundit. Do t'ia dalim!", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka reaguar pas votimit të Komitetit LIBE. "Votimi pro liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës nga Komiteti për Liritë Qytetare, Drejtësi dhe Çështje të Brendshme - LIBE, është lajm i mirë për qytetarët e Kosovës. Votimi i sotëm shënon një tjetër hap në rrugën drejt liberalizimit të vizave. Me votimin e sotëm konfirmohet edhe një herë se vendi ynë i ka përfunduar të gjitha kriteret e kërkuara për liberalizimin e vizave. Qytetarët e Kosovës e meritojnë t'u hiqet izolimi dhe të lëvizin lirshëm në Zonën Shengen", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Vendimi i Komitetit LIBE është përshëndetur edhe nga kryetarja e Komisionit për Integrime Evropiane, Blerta Deliu-Kodra dhe ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha. Kjo e fundit beson se i tërë procesi do të përmbyllet brenda këtij viti. "Pas votimit në Komision procesi vazhdon në seancën plenare të Parlamentit Evropian që pritet të mbahet në mesin e shtatorit të këtij viti, pastaj në Këshillin e Ministrave e tutje. Kosova ka përmbushur të gjitha kushtet që janë kërkuar dhe presim që procesi i vendimmarrjes të përmbyllet brenda këtij viti, megjithatë tashmë çdo gjë është në dorën e institucioneve të BE-ë.", ka shkruar Hoxha në profilin e vet në "Facebook".

Më 18 korrik të këtij viti Komisioni Evropian ka vlerësuar se Kosova i ka plotësuar dy kushtet e mbetura për liberalizim vizash: luftën më të theksuar kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi.



Flet për "Epokën e re", Naser Rugova

# Kuvendi ta parandalojë iniciativën



**Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Naser Rugova, ka thënë se Kuvendi duhet ta thotë fjalën e fundit lidhur me idenë për korrigjimin e kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka deklaruar se deputetët më 4 shtator duhet ta miratojnë rezolutën për ruajtjen e integritetit territorial të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Rugova ka theksuar se Kuvendi duhet të parandalojë çfarëdo iniciative që rrezikon sovranitetin dhe tërësinë territoriale të shtetit. Ai ka shprehur optimizëm se rezoluta për këtë çështje do të mbështetet nga të gjitha partitë, përfshirë edhe ato të pushtetit. Rugova ka bërë me dije se opozita është në rrugën e duhur për t'i siguruar votat për rrëzimin e Qeverisë**

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

**Prishtinë, 30 gusht** - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Naser Rugova, ka thënë të enjten se thirrja e seancës urgjente nga partitë opozitare ka për qëllim ruajtjen e sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se askush nuk ka të drejtë t'i negociojë kufijtë dhe territorin e Kosovës. "Lidhja Demokratike e Kosovës, si grupi më i madh parlamentar pas ngjarjeve të fundit dhe deklarimeve konfuze të presidentit të vendit, e ka parë të rëndësishme të koordinohet me partitë e tjera opozitare, me ç'rast kemi mbledhur nënshkrimet e nevojshme për mbajtjen e seancës që para takimit të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe atij të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ta heqim çdo dilemë që bie ndesh me Kushtetutën dhe interesin nacional të Kosovës", është shprehur Rugova, duke shtuar se Kuvendi duhet të parandalojë çfarëdo iniciative që rrezikon sovranitetin dhe tërësinë territoriale të shtetit. "Është me rëndësi të madhe të ndërtohet një konsensus rreth parimeve kryesore kushtetuese siç është ruajtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës. Do t'i ndërmarrim të gjithë hapat e nevojshëm kushtetues dhe ligjorë që përmes Kuvendit ta parandalojmë çfarëdo aventure që rrezikon tërësinë territoriale të Kosovës", ka deklaruar ai. Rugova ka shprehur optimizëm se rezoluta për këtë çështje do të mbështetet nga të gjitha partitë, përfshirë edhe ato të pushtetit. Ai ka bërë me dije se opozita është në rrugën e duhur për t'i siguruar votat për rrëzimin e Qeverisë. Sipas Rugovës, duhet të shkohet në zgjedhje të reja në mënyrë që vendi të shpëtojë nga dëmtimi që po i kanoset nga qeveria aktuale.

**"Epoka e re":** *Z. Rugova, LDK-ja me mbështetjen e dy partive të tjera opozitare ka dorëzuar kërkesën për seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit, siç është thënë, për ta shprehur qëndrimin institucional kundër cenimit të territorit të Republikës së Kosovës. Prisni që kjo iniciativë të ketë sukses?*

**Rugova:** Lidhja Demokratike e Kosovës, si grupi më i madh parlamentar, pas ngjarjeve të fundit dhe deklarimeve konfuze të presidentit të vendit, e ka parë të rëndësishme të koordinohet me partitë e tjera opozitare, me ç'rast kemi mbledhur nënshkrimet e nevojshme për mbajtjen e seancës që para takimit të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe atij të Serbisë, Aleksandër Vuçiq ,ta heqim çdo dilemë që bie ndesh me Kushtetutën dhe interesin nacional të Kosovës. Pika e vetme e kësaj seance urgjente është ruajtja e tërësisë territori-

# që rrezikon tërësinë territoriale



ale të Kosovës, sepse askush nuk ka të drejtë t'i negociojë kufijtë dhe territorin e Kosovës, përfshirë këtu edhe presidentin e vendit. Ne si mazhorancë, meqë flitet për 58 deputetë të shumicës shqiptare, e kemi parë të arsyeshme dhe të nevojshme që Kuvendi i Republikës së Kosovës, si institucioni më i lartë i vendit, ta thotë fjalën e vet lidhur me idenë për korrigjimin e kufirit. Ky është qëllimi i thirrjes së kësaj seance me iniciativë të LDK-së, e mbështetur edhe nga dy partitë e tjera opozitare.

**"Epoka e re":** *Keni arritur të siguroni mbështetjen e shumicës parlamentare për miratimin e rezolutës lidhur me këtë çështje?*

**Rugova:** Jemi të bindur se rezoluta e propozuar nga partitë opozitare do ta marrë mbështetjen e deputetëve të Kuvendit duke ditur se edhe partnerët e koalicionit qeverisës kanë diskrepanca të mëdha në qëndrime. Edhe publikisht dihet se partia e kryeministrit Haradinaj, AAK-ja dhe partia e zëvendëskryeministrit Limaj, Nisma Socialdemokrate, janë kundër idesë për korrigjimin e kufirit. Është me rëndësi të madhe të ndërtohet një konsensus rreth parimeve kryesore kushtetuese siç është ruajtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës. Ky parim ka dalë nga pakoja e Ahtisarit, Kushtetuta e Kosovës dhe këtë e forcon edhe më shumë opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND). Konsiderojmë se deklaratat për korrigjimin e kufijve shkaktojnë panik dhe janë kundërkushtetuese dhe nuk janë në interes të Kosovës. Ne jemi për dialog, po ashtu jemi për arritjen e një konsensusi që vendi të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme parlamentare, pastaj ai që e fiton legjitimitetin popullor elektoral do ta udhëheqë fazën e fundit të dialogut me Serbinë. Ky dialog duhet të jetë i barabartë, me parime të reciprocitetit dhe të përfundojë me njohje reciproke.

**"Epoka e re":** *Cilët do të jenë hapat që do të ndërmerren nëse dështon miratimi i rezolutës?*

**Rugova:** Në bazë të kalkulimeve tona dhe bisedave me partnerët opozitarë, por edhe me partitë politike që janë pjesë e koalicionit, të cilat publikisht po e kundërshtojnë idenë për shkëmbim të territoreve dhe atë për rishikim të kufijve, e kanë mbështetur qëndrimin tonë për ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial. Këtë hartë të Kosovës e kanë njohur mbi 111 shtete dhe ne besojmë se do t'i kemi votat e mjaftueshme. LDK-ja e ka obligim politik dhe moral, por edhe kushtetues, t'i marrë këta hapa dhe të heqë çdo dilemë në mënyrë që Kuvendi ta thotë fjalën e vet me një debat cilësor dhe kualitativ, që do të ketë karakter gjithëpërfshirës. U bëjmë thirrje edhe partive të komuniteteve joserbe që ta na mbështesin sepse është interes i të gjithë qytetarëve të Kosovës, në veçanti është në interes për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në rajon, Kosova me kufijtë aktualë.

**"Epoka e re":** *Deputetja Vjosa Osmani ka bërë thirrje që të protestohet në ditën kur në Bruksel do të takohen Thaçi dhe Vuçiqi.*

**Rugova:** Deputetja Osmani ka deklaruar se apeli për protesta ka qenë qëndrim i saj individual. LDK-ja e ka kryetarin, Kryesinë, Këshillin e Përgjithshëm dhe grupin parlamentar. Pas seancës së jashtëzakonshme do t'i bëjmë analizat e nevojshme. LDK-ja me logjikën institucionale do t'i shtjerrë të gjitha mundësitë kushtetuese dhe ligjore. Vetëm Kryesia e LDK-së është kompetente të marrë vendime të tilla. Do t'i ndërmarrim të gjithë hapat e nevojshëm kushtetues dhe ligjorë që përmes Kuvendit ta parandalojmë çfarëdo aventure që rrezikon tërësinë territoriale të Kosovës. Ne ende nuk kemi biseduar dhe nuk e kemi hapur temë protestën, prandaj deklarimi i deputetes ka qenë apel individual. Përndryshe, grupi parlamentar i LDK-së është unik dhe jemi në harmoni të plotë me secilin vendim që e merr Kryesia e LDK-së.

**"Epoka e re":** *Z. Thaçi po e akuzon opozitën, se me këto qëndrime po e vë në pikëpyetje mbështetjen ndërkombëtare për Kosovën.*

**Rugova:** Iniciativa e opozitës është kushtetuese dhe ligjore. Nuk dua t'i komentoj deklarimet e presidentit Thaçi, por mund të them me përgjegjësi të plotë se LDK-ja dhe opozita duan të largojnë çdo shqetësim dhe çdo mjegull sa i takon sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës.

**"Epoka e re":** *Keni deklaruar se LDK-ja është pro shkuarjes së vendit në zgjedhje të parakohshme. A i keni siguruar votat për rrëzimin e Qeverisë?*

**Rugova:** Me koordinimin dhe organizimin që kemi bërë këto ditë me kolegët tanë opozitarë, jemi duke biseduar edhe me partitë që janë pjesë e koalicionit qeverisës, në mënyrë që t'i sigurojmë votat e nevojshme që ta largojmë këtë Qeveri nga pushteti. Kjo, mbase, është Qeveria më e dobët në shtatë dekadat e fundit. Duhet të shkohet në zgjedhje të parakohshme në mënyrë që vendi të shpëtohet nga dëmtimi serioz që po i kanoset nga kjo Qeveri e papërgjegjshme. Jemi duke u angazhuar seriozisht për ta bërë kuorumin e nevojshëm për largimin e kësaj qeverie.

**"Epoka e re":** *Keni arritur marrëveshje me ndonjë prej deputetëve nga radhët e partive në pushtet për ta rrëzuar Qeverinë?*

**Rugova:** Ne kemi biseduar me deputetët e partive në pushtet të cilët janë shumë të pakënaqur me gjendjen aktuale. Jemi optimistë se pas këtij organizimi opozitar dhe pas këtij presioni qytetar do t'i sigurojmë votat e nevojshme për rrëzimin e Qeverisë, e cila është Qeveria më e dëmshme për vendin që nga viti 1945. Pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme duhet të formohet një Qeveri kredibile për ta nxjerrë Kosovën nga ky vorbull dhe nga ky depresion kolektiv.

**"Epoka e re":** *Shtatori mund ta sjellë mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë Haradinaj?*

**Rugova:** Nuk dua të flas për data, por jemi në rrugë të mirë dhe nuk do të ndalemi deri në rrëzimin e Qeverisë Haradinaj.

# Drejtoritë komunale të arsimit, të gatshme për fillimin e vitit të ri shkollor



EPOKA E RE **Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 30 GUSHT - Drejtoritë komunale të arsimit janë shprehur të gatshme për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019, i cili fillon më 3 shtator. Kështu është thënë në takimin e radhës të Kolegjiumit për Arsim të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK). Takimi në fjalë është hapur nga kryesuesi i këtij kolegjiumi, Besim Avdimetaj, i cili ka thënë se ky takim është thirrur me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të parapara me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës (MAShT), për një fillim sa më të mbarë të vitit të ri shkollor.

Për këtë arsye në takim kanë qenë të ftuar përfaqësuesit e MAShT-it, ku nga kjo ministri i pranishëm ishte sekretari i përgjithshëm, Ekrem Kastrati, i cili ka shprehur gatishmërinë e vet dhe të MAShT-it për bashkëpunim me Kolegjiumin e Drejtorëve të Arsimit si dhe me AKK-në me qëllim të avancimit të sistemit edukativ në komuna. Ai ka kërkuar nga komunat mirëkuptim në procesin e ardhshëm të shpërndarjes së teksteve shkollore nëpër komuna, punë kjo e cila kërkon angazhime shtesë nga DAK-të komunale në këtë fillimvit shkollor.

# Kërkohet të rritet presioni ndaj Serbisë për të zhdukurit

PRISHTINË, 30 GUSHT (ER) - Në Ditën Ndërkombëtare për Personat e Zhdukur, në Prishtinë, Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut ka organizuar një marsh.

Qytetarët kanë mbajtur në duar emrat e personave të pagjetur, që nga lufta e fundit në Kosovë, e vitit 1999. Në Kosovë konsiderohen të pagjetur 1 648 persona.

Kryeministri Hashim Thaçi ka thënë se të zhdukurit e luftës vazhdojnë të jenë plagë e hapur për Kosovën. "Sot, në Ditën Ndërkombëtare për Persona të Zhdukur, iu bashkova familjarëve në ecjen drejt gjurmëve që simbolizojnë zbardhjen e fatit të të pagjeturve jo vetëm për solidarizim me ankthin e tyre, por edhe për t'u dhënë mbështetje atyre që angazhohen, që kjo çështje të marrë epilog. Do të bëjmë çmos për ta zbardhur fatin, edhe të njeriut të fundit të Kosovës, të zhdukur gjatë luftës", ka thënë Haradinaj.

Ndërkaq ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, në Ditën Ndërkombëtare për Persona të Zhdukur, u është drejtuar me një letër ministrave të drejtësisë të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, nga të cilët ka kërkuar angazhim për zbardhjen e fatit të të zhdukurve.

Në letrën e tij ministri Tahiri ka shprehur shqetësimin institucional dhe shoqëror për ndaljen e plotë të zbardhjes së fatit të të zhdukurve nga lufta në Kosovë. "Si ministër i Drejtësisë e kam vendosur prioritetet trajtimin e kësaj çështje gjatë mandatit tim dhe jam plotësisht i gatshëm për ta ofruar mbështetjen e nevojshme institucionale që secili rast i të pagjeturve, pavarësisht prej përkatësisë etnike, të gjejë zgjidhje të shpejtë. Për këtë jemi duke punuar ngushtë edhe me







Misionin Evropian të Sundimit të Ligjit që është duke ndihmuar kapacitetet tona të mjekësisë ligjore. Megjithatë, adresa reale e kësaj çështje është e ditur botërisht. Republika e Serbisë duhet t'i hapë arkivat e veta dhe të ofrojë informata për secilin rast, në mënyrë që identifikimi dhe gjurmimi i lokacioneve ku mund të jenë eshtrat e viktimave të luftës së fundit, të bëhet sa më shpejt, dhe që ky kapitull i rëndë i historisë sonë të përmbyllet", ka shkruar ministri Tahiri.

Ministri Tahiri ka theksuar se kjo çështje kërkon zgjidhje përtej politike, meqenëse prek humanizmin dhe ndërgjegjen kolektive të popujve ndaj njëri-tjetrit, andaj ka kërkuar që kjo temë të ngrihet në çdo takim që ministrat e BE-së kanë me përfaqësuesit e Republikës së Serbisë. "Me konsideratën më të lartë dhe duke ju ftuar për një reflektim mbi bazat e humanizmit dhe parimeve më të shëndosha mbi të cilat është ngritur civilizimi evropian, kërkoj që këtë temë ta keni në agjendë të bisedimeve me përfaqësuesit dhe diplomatët e Republikës së Serbisë në çdo rrethanë dhe në çdo rast që ju jepet. Vetëm duke zbardhur fatin e të pagjeturve do të mund të rehabilitohen familjet tona dhe shoqëria jonë në përgjithësi. Unë besoj në vlerat e qytetërimit evropian dhe besoj tek mandati juaj, si institucionalistë të zgjedhur, për të shërbyer në përputhje të këtyre vlerave", ka shkruar në letrën e vet ministri Tahiri.

# Klinika Obstetrike Gjinekologjike furnizohet me pajisje moderne

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 30 GUSHT - Klinika Obstetrike Gjinekologjike e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) është pajisur me aparaturë moderne e cila mungonte dhe përmes së cilës do t'i mundësohet stafit shëndetësor të kësaj klinike t'i diagnostikojë dhe mjekojë më lehtë sëmundjet. Edhe pacientët do të kenë mundësi të marrin shërbime shëndetësore me aparaturë dhe metodat më bashkëkohore.

Të enjten kësaj klinike i është dorëzuar një histeroskop modern në vlerë prej 80 mijë eurosh, për diagnostifikim dhe mjekim të patologjive të ndryshme të mitrës, dhe një thikë ultrasonografike, të gjitha në vlerë prej 30 mijë eurosh.

Me rastin e dorëzimit të kësaj aparature, ministri i Shëndetësisë i Republikës së Kosovë, Uran Ismaili, ka thënë se këto dy pajisje po dorëzohen në mënyrë që spitalet të jenë moderne dhe me kushte më të mira për mjekët dhe për pacientët. "Për herë parë në gjinekologji do të përdoren procedura më të lehta, do të shkurtohen ditët e qëndrimit, në anën tjetër pajisjet e reja do të bëjnë që pacientët të mos paguajnë para për trajtim jashtë", ka thënë Ismaili, duke shtuar se mjekët në vendin tonë janë në nivel profesional. "Vetëm dje Klinika e Gjinekologjisë ka pasur 48 lindje që tregon se kjo klinikë frekuentohet shumë dhe kanë pasur nevojë për pajisje të tilla që do t'i hyjnë në punë doktorëve dhe pacientëve tanë" është shprehur ministri Ismaili. Sipas tij, të gjitha pajisjet janë blerë dhe do të blihen nga paratë e buxhetit të Kosovës dhe nuk do të lihen institucionet shëndetësore në mëshirë të donacioneve. "Është përgjegjësi më madhe si shtet për të blerë pajisje të nevojshme, meqë pacientët po shkojnë privat, mjekët janë të kualifikuar për ta kryer punën këtu, shumica e mjekëve janë të nivelit të lartë, nevojat për mbështetje janë të mëdha dhe këtë po fillojmë ta konkretizojmë sot", ka thënë ai.

Ndërsa drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), dr. Basri Sejdiu, ka theksuar se dorëzimi i pajisjeve të reja do të mundësojë kushte më të mira për mjekët dhe për pacientët. "Kemi 3.5 milionë euro për blerje të pajisjeve që janë proceduar. Deri në fund të shtatorit dhe tetorit të gjitha klinikat do të pajisen me aparatura, e që shumica e pacientëve janë dërguar jashtë vendit në mungesë të tyre. Po ashtu, është dëmtuar buxheti dhe xhepi i pacientëve. Ne jemi mbështetur edhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe do të krijojmë kushte dhe pajisje moderne që pacientët të gjejnë trajtim në institucionet publike", ka thënë Sejdiu.

Drejtoresha e Klinikës Obstetrike Gjinekologjike, Myrvete Paçarada, ka pohuar se këto pajisje nuk i ka pasur më parë klinika. Ajo ka treguar se me këto pajisje do të bëhet e mundur të rritet cilësia e operacioneve dhe do të kursehet edhe buxheti i shtetit, meqë pacientët nuk do të kenë nevojë të referohen për trajtim jashtë vendit.



Takohen në Presidencën e Kosovës liderët shtetërorë

# Thaçi rikonfirmon idenë për korrigjim të kufirit



Në zyrën e presidentit Hashim Thaçi të enjten kanë qenë kreu i Kuvendit, Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj dhe tre zëvendëskryeministrat, Behgjet Pacolli, Fatmir Limaj dhe Dardan Gashi. Në këtë takim të përbashkët është diskutuar për dialogun, kurse mungonin përfaqësuesit e opozitës. Presidenti Thaçi ka theksuar se asnjë marrëveshje nuk do të ndodhë nga ana e Kosovës pa pëlqimin e plotë të ShBA-së, BE-së dhe NATO-s

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 30 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se në dialogun me Serbinë nuk mund të bisedohet për territorin dhe kufijtë e Kosovës. Pas takimit që ai dhe krerë të tjerë institucionalë kanë pasur të enjten me presidentin Hashim Thaçi, Haradinaj ka theksuar se në këtë takim është bërë e qartë se askush nuk mund të bisedojë me Serbinë për kufijtë e Kosovës. "Njohja reciproke është e nevojshme. Procesi i dialogut nuk nënkupton diskutim të territorit, as të kufijve të Kosovës. Presidenti shprehu pozicionin e vet se respekton jo vetëm territorin, integritetin, sovranitetin e vendit, por vetëm i ushtron funksionet e veta në kuadër të Kushtetutës dhe nuk pranon të diskutohet territori i vendit", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se çështja e kufijve nuk do të jetë pjesë e dialogut. "Ajo çka është me rëndësi është të kemi qëndrim të qartë institucional se kufijtë nuk diskutohen. Nuk janë çështje për diskutim në kuadër të dialogut", ka deklaruar Haradinaj pas takimit. Sipas tij, pjesëmarrja e opozitës në dialog është shumë e rëndësishme.

Në takim me presidentin Thaçi, ishin edhe kryeparlamentari Kadri Veseli dhe zëvendëskryeministrat Behgjet Pacolli, Fatmir Limaj dhe Dardan Gashi. Pas këtij takimi liderët institucionalë kanë zhvilluar një takim edhe me ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, Greg Delawie, në zyrën e presidentit të vendit, Hashim Thaçi. Ky i fundit ka vazhduar ta mbështesë idenë e proklamuar që marrëveshja paqësore me Serbinë ta përfshijë edhe korrigjimin e kufirit.

Ai ka deklaruar të enjten se marrëveshja nuk do të përfshijë "ndarje dhe as shkëmbim të territorit me Serbinë" por, sipas tij, mund të bëhet një korrigjim, duke përfshirë brenda territorit të Kosovës komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. "Përfundimisht dhe zyrtarisht i pëlqeu dikujt apo jo, unë do ta shtroj kërkesën e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit që ajo pjesë t'i bashkëngjitet territorit të Kosovës. Unë nuk kam ndonjë nostalgji për vijat që janë përcaktuar në kohën më të vështirë të dëbimit të shqiptarëve të vitit 1956", ka thënë Thaçi. Ai ka siguruar se për çfarëdo veprimi të ndërmarrë është në koordinim me ShBA-në, BE-në dhe NATO-në. "Asnjë marrëveshje nuk do të ndodhë nga ana e Kosovës pa pëlqimin e plotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Kushdo që del kundër, e ka gabim", ka deklaruar Thaçi.

Këto komente ai i ka bërë pas marshit të organizuar në Ditën Ndërkombëtare për Personat e Zhdukur. Për dialogun Kosovë - Serbi, presidenti Hashim Thaçi ka zhvilluar të enjten një bisedë telefonike me ndihmëssekretarin e Shtetit të ShBA-së për Çështje Evropiane dhe Euroaziatike, Wess Mitchell. "Ndihmëssekretarin Mitchell e falënderova për qëndrimin e qartë të ShBA-së, për arritjen e një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në kuadër të fazës së fundit të dialogut", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka pohuar se me zyrtarin e lartë amerikan janë pajtuar t'i shtojnë përpjekjet për të arritur një marrëveshje e cila njëherë e përgjithmonë do t'i mbyllë armiqësitë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Një marrëveshje e cila i hap rrugë njohjes reciproke dhe perspektivës së qartë të Kosovës për anëtarësim në NATO, BE, OKB dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Ndihmëssekretari Mitchell u zotua se Kosova do ta ketë mbështetjen e palëkundur të ShBA-së në këtë proces. Përfshirja e ShBA-së dhe partnerëve të tjerë strategjikë të Kosovës në fazën e fundit të dialogut, të lehtësuar nga BE-ja, është një garanci për suksesin e plotë dhe arritjen e një marrëveshjeje historike. Miqësia dhe besimi në ShBA-në do të jetë i përjetshëm", ka shkruar Thaçi.

Bazuar në deklaratat e dy presidentëve në Forumin Evropian të mbajtur në Alpbach të Austrisë gjatë fundjavës, korrigjimi i kufirit do të jetë pjesa kryesore e marrëveshjes që Thaçi e Vuçiqi synojnë të arrijnë. Mirëpo, partitë opozitare në Kosovë janë duke tentuar ta ndalojnë presidentin Thaçi të takohet sërish me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq.

Lidhja Demokratike e Kosovës, e përkrahur edhe nga partitë e tjera opozitare, ka paralajmëruar seancë të jashtëzakonshme më 4 shtator, tri ditë para takimit të dy presidentëve. Në këtë seancë partitë opozitare kanë paralajmëruar se do ta nxjerrin një rezolutë përmes së cilës do të mund ta ndalojnë presidentin Hashim Thaçi ta vazhdojë dialogun me Vuçiqin.

Kjo kërkesë për seancë të jashtëzakonshme është quajtur absurde nga kreu i Kuvendit, Kadri Veseli. Ndërsa partnerët e PDK-së në koalicionin qeverisës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma Socialdemokrate, e kanë mbështetur këtë kërkesë të opozitës për seancë të jashtëzakonshme.

## Edita Tahiri: Kuvendi ka përgjegjësinë historike t'i thotë jo ndryshimit të kufijve

Prishtinë, 30 gusht (ER) - Ishkryenegociatorja e Kosovës për bisedimet me Serbinë, Edita Tahiri, ka ftuar Kuvendin e Kosovës ta kundërshtojë ndryshimin e kufijve të Kosovës. Në profilin e vet në "Facebook" ajo ka shkruar se ky institucion ka përgjegjësinë historike t'i thotë jo ndryshimit të kufijve të Kosovës. "Tash Kuvendi i Kosovës e ka përgjegjësinë historike t'i thotë jo ndryshimit të kufijve të Kosovës, për të cilën bëmë luftë dhe u flijuam 100 vjet. Ta mbrojmë fitoren e luftës çlirimtare ndaj Serbisë më 1999 dhe t'i mposhtim ambiciet hegjemoniste të Serbisë dhe agjendave gjeopolitike ruse", ka shkruar Tahiri.



# Matoshi e Pacolli, projekte konkrete për kryeqytetin

**Prishtinë, 30 gusht (ER)** - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka ndarë 150 mijë euro për Komunën e Prishtinës në mbështetje të dy projekteve: të ndërtimit të ujësjellësit në fshatin Rimanishtë dhe ndërtimin e deponisë së materialeve të ngurta në kryeqytet.
Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, dhe nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Selim Pacolli, gjatë një takimi të përbashkët kanë nënshkruar të enjten këto dy marrëveshje bashkëpunimi.
Gjatë ceremonisë së nënshkrimit, ministri Matoshi ka thënë se MMPH-ja do të angazhohet fuqishëm për realizimin e projekteve me komunat e Kosovës, përfshirë këtu edhe Prishtinën. "Nënshkruam marrëveshje për bashkëfinancim të dy projekteve 'Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Rimanishtë' në vlerë prej 100 mijë eurosh si dhe 'Ndërtimi i deponisë së materialeve të ngurta në Prishtinë', i cili ka vlerën 50 mijë euro në vitin fiskal 2018. Si MMPH po mbështesim komuna dhe regjione të caktuara që të krijojmë kushte për t'i vazhduar punët serioze me deponitë e mbetjeve të ngurta", ka thënë Matoshi. Ai ka thënë se Prishtina është kryeqyteti i të gjithëve dhe si e tillë do të trajtohet nga MMPH-ja duke e mbështetur në projekte edhe në vitet e ardhshme.
Ndërsa nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Selim Pacolli, ka thënë se nënshkrimi i dy memorandumeve është vazhdimësi e bashkëpunimit mes MMPH-së dhe qeverisjes së kryeqytetit. "Kjo është një vazhdimësi e bashkëpunimit të Komunës së Prishtinës me MMPH-në, në mbështetje të projekteve të ndryshme. Besoj se nuk do të jenë projektet e fundit dhe ne do të bashkëpunojmë në këtë mënyrë që t'u ofrojmë kushte më të mira banorëve tanë", ka thënë Pacolli.




Gjatë këtij takimi Matoshi dhe nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Pacolli, diskutuan edhe për Task Forcën për Cilësinë e Ajrit në Prishtinë dhe Task Forcën "Ta pastrojmë Kosovën", aksion ky i cili fillon më 15 shtator.

# MMPH-ja planifikon financimin e ndërtimit të stacioneve hidrometrike dhe hidrometeorologjike



**Prishtinë, 30 gusht (ER)** - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, të enjten është takuar me kryetarin e Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, me ç'rast kanë diskutuar për projektin "Hidrosistemi Kikë - Kremenatë", i cili financohet nga MMPH-ja.
Gjatë këtij takimi ministri Fatmir Matoshi dhe kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, kanë rënë dakord që në kuadër të projektit "Hidrosistemi Kikë - Kremenatë", të ndërtohen tri stacione hidrometrike dhe dy stacione hidrometeoroligjike të cilat parashihet ta bëjnë matjen e nivelit të ujërave e cila do të shërbejnë për studimin e fizibilitetit.
Ministri Matoshi ka thënë se krijimi i rezervave ujore në Kosovë është prioritet i ministrisë që ai drejton. "Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në kuadër të politikave të veta kujdes të veçantë do t'i kushtojë krijimit të rezervave ujore përmes krijimit të digave të reja. Hidrosistemi Kikë - Kremenatë është prioritet i MMPH-së dhe në këtë aspekt ne po ndërmarrim hapa konkretë për realizimin e këtij projekti madhor", ka deklaruar Matoshi.
Ai ka premtuar mbështetje të vazhdueshme për Komunën e Kamenicës në projektet që kanë për qëllim përmirësimin e mjedisit. Ndërsa kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, pasi ka falënderuar ministrin për përkrahjen, e ka vlerësuar të domosdoshëm ndërtimin e stacioneve hidrometrike dhe hidrometeorologjike në kuadër të projektit "Hidrosistemi Kikë - Kremenatë". "Ne e kemi bërë strategjinë për zhvillim për ujëra në Kosovë, ku është paraparë vendosja e tri stacioneve ujëmatëse dhe të shiut që do ta bëjnë matjen në periudhë njëvjeçare", ka thënë Kastrati.

## Prishtina subvencionoi me 140 000 euro blegtorët dhe me 50 000 euro bletarët

**Prishtinë, 30 gusht (ER)** - Drejtoria e Bujqësisë në Prishtinë ka realizuar projektin e subvencionimit të fermerëve në fushën e blegtorisë dhe bletarisë. Për blegtori janë përkrahur fermerët që kanë 3-10 krerë gjedhe qumështore, ndërsa 30-150 krerë dele dhe dhi. Nga 313 fermerë që kanë aplikuar, kriteret i kanë plotësuar 291 sosh. Shuma e ndarë për një gjedhe është 53 euro, kurse për një dele ose një dhi 10 euro. Në bletari janë përkrahur të gjithë ata që kanë pasur 10-30 shoqëri të bletëve, ku prej 223 aplikantëve, 219 i kanë plotësuar kushtet. Për një shoqëri të bletëve janë ndarë nga 8.5 euro.



# Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit: Vendimi i ZRrE-së, joligjor dhe zhvatës

Kryesuesi i Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit, Sherif Zejnullahu, e ka quajtur të turpshëm dhe joligjor vendimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE) që humbjet në rrjetin energjetik t'i paguajnë qytetarët




EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 30 GUSHT (ER) - Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit e ka quajtur të turpshëm dhe joligjor vendimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE), që humbjet në rrjetin energjetik t'i paguajnë qytetarët. Në një konferencë për medie, Sherif Zejnullahu, kryesues i këtij këshilli, ka thënë se nëse Korporata Energjetike e Kosovës ka humbje, ZRrE-ja nuk ka të drejtë që ato t'ia faturojë qytetarit. "KEDS-i dhe Qeveria kanë kontratë të përbashkët. Nëse ZRrE-ja arsyetohet se KEK-u ka humbje, KEK-u është palë e tretë dhe nuk ka të drejtë ZRrE-ja të marrë vendim që humbjet e palës së tretë t'ia faturojë konsumatorit. Ky vendim i marrë më 20 gusht është antiligjor, antimoral, i dëmshëm dhe nuk gjen arsyeshmëri", ka deklaruar Fejzullahu.

Ai ka thënë se është e padrejtë kur thuhet nga KEDS-i dhe ZRrE-ja se ky vendim për faturim tek konsumatori është normal. "Këshilli është i indinjuar me këtë vendim dhe ne porositim konsumatorët që këtë dëm në asnjë mënyrë mos ta pranojnë", ka thënë Fejzullahu. Sipas tij, humbjet e KEK-ut, që ZRrE-ja dëshiron t'i rregullojë përmes konsumatorëve, është e padrejtë dhe konsumatorët dhe qytetarët duhet ta ngrehin zërin e tyre. Ndërsa anëtari i Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit, Selatin Kaçaniku, i mllefosur me vendimin e ZRrE-së, ka thënë se kjo është hera e parë që ky këshill reagon në këtë mënyrë pasi, sipas tij, humbjet e të tjerëve po u faturohen qytetarëve në xhepat e tyre. "Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e KEDS-it u faturohen qytetarëve dhe ne e konsiderojmë vendim joligjor, indinjues, detyrues apo më mirë thënë, zhvatës, të turpshëm dhe të papranueshëm. Konsumatori nuk e ka obligim dhe as përgjegjësi t'i mbulojë humbjet e KEK-ut dhe as të Qeverisë", është shprehur Kaçaniku. Ai ka theksuar se vendimi i ZRrE-së është plotësisht i kundërligjshëm, me të cilin do të pësojnë konsumatorët, pasi ndikon në rritjen e çmimit të energjisë.

# Apostolova: Kemi investuar 40 milionë euro në projekte për Kosovën



GJILAN, 30 GUSHT (ER) - Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka zhvilluar një takim me kryetarët e komunave të regjionit të Anamoravës. Me këtë rast, ajo ka thënë se Bashkimi Evropian (BE) në Kosovë ka investuar 40 milionë euro në projekte për Kosovën, megjithatë ka potencuar se do ta vazhdojë mbështetjen. "Do të synojmë ta shtojmë mbështetjen për fermerët e të gjitha fushave. Rinia është pjesa kryesore e vendit. Projektet që do t'i mbështetim janë projektet e infrastrukturës, por edhe grantet. Ne po planifikojmë pakon e re që po synojmë ta dedikojmë për Kosovën. Por, sipas rregullave, duhet të dimë se çfarë projekte të mbështesim", ka thënë Apostolova.

Ndërsa kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka deklaruar se regjioni i Anamoravës ka nevojë për përkrahje më të madhe, por edhe për promovim më të madh. Ndërsa kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, problem në komunën që drejton ka thënë të jetë uji i pijshëm, ani pse ky vend ka ujë të mjaftueshëm.

Më tutje, kryetari i Komunës së Parteshit, Dragan Petkoviq, ka thënë se rinia e kësaj komune po largohet. Edhe kryetari i Lomunës së Ranillugut, Vladica Aritonoviq, ka thënë se problemi në komunën e tij është largimi i të rinjve nga kjo komunë. Kurse kryetari i Komunës së Novobërdës, Zvetislav Ivanoviq, ka vlerësuar se duhet të bëhet më shumë për këtë komunë për zhvillim të turizmit.

Nikoqiri i këtij takimi, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se prioritet i kësaj komune është rregullimi i shtratit të Moravës.

# Komuna e Shtimes, fituese e grantit të performancës

**Shtime, 30 gusht (ER)** - Kryetari i Komunës së Shtimes, Naim Ismajli, është informuar nga Komisioni i Grantit të Performancës për kualifikimin e kësaj komune për marrjen e grantit të performancës për vitin 2017. Me këtë rast, kryetari Ismajli ka falënderuar Komisionin e Grantit të Performancës për këtë grant. "Në emër të institucionit të Komunës së Shtimes, në emër të qytetarëve të Komunës së Shtimes, përshëndes dhe falënderoj Komisionin e Grantit të Performancës, kënaqësi që komuna jonë është kualifikuar sërish për marrjen e grantit të performancës, falë përmbushjes së kushteve të cilat përfshijnë: i) nënshkrimin e marrëveshjes së pjesëmarrjes trepalëshe; ii) marrjen e opinionit të pamodifikuar me theksim të çështjes nga Auditori; dhe iii) të kemi shpenzuar 75 për qind ose më shumë të buxhetit të investimeve kapitale. Jemi zotuar të jemi pranë qytetarëve dhe do të vazhdojmë të ofrojmë shërbime cilësore për të gjithë qytetarët në komunën tone", ka thënë Ismajli.

Rezultati i përgjithshëm i performancës së Komunës së Shtimes është 59 pikë, ka njoftuar stafi i Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL) dhe i projektit të DEMOS-it.






# Prokuroria Themelore në Pejë vazhdon hetimin e listave të veteranëve të luftës

**Pejë, 30 gusht (ER)** - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Pejës, Agim Kurmehaj, ka mbajtur të enjten takim me Njësitin për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion dhe Sektorin Rajonal të Hetimeve në Pejë.

Gjatë këtij takimi kryeprokurori Kurmehaj ka kërkuar shtimin e veprimeve hetimore për rastin e mashtrimeve me listat e veteranëve të luftës, duke përfshirë edhe zinxhirin komandues të UÇK-së, që janë nën kompetencë territoriale të Prokurorisë Themelore të Pejës. Po gjatë këtij takimi u nxorën disa konkluzione, ku kryeprokurori Kurmehaj ka njoftuar se për këtë rast ka caktuar një prokuror i cili do të merret ekskluzivisht me këto lëndë. Sipas tij, në rast nevoje do të caktohet edhe ndonjë prokuror tjetër.

Gjitha këto veprime nga kjo prokurori janë ndërmarrë në koordinim të plotë me kryeprokurorin e Shtetit, Aleksandër Lumezi.

Prokuroria e Pejës, me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe luftimit të kësaj dukurie, do të mbajë çdo dy javë takime të rregullta. Vlen të theksohet se lidhur me rastet e mashtrimit të listave të veteranëve, Prokuroria Themelore e Pejës ka hapur disa hetime, njëkohësisht ka ngritur një aktakuzë muajin e kaluar.



# Ramosaj inspekton punimet në shkollën 'Sylejman Vokshi'

**Deçan, 30 gusht (ER)** - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, në prag të fillimit të vitit shkollor, ka inspektuar punimet që janë duke u kryer në renovimin e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Sylejman Vokshi" në fshatin Prilep të kësaj komune. "Së bashku me inxhinierët e komunës inspektuam punimet që janë duke u kryer në renovimin e Sh.F.M.U 'Sylejman Vokshi' në Prilep", ka thënë Ramosaj. Më 3 shtator pritet të fillojë viti shkollor në të gjitha shollat fillore dhe të mesme të Republikës së Kosovës.

# Nënshkruhet marrëveshja për rregullimin e lumit Sitnica

**Mitrovicë, 30 gusht (ER)** - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka mirëpritur të enjten në një takim bashkëpunëtorin kryesor të Ambasadës së Francës, Joseph Giustiani, me të cilin ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi lidhur me menaxhimin e Lumit Sitnica.

Me këtë marrëveshje parashihet përmirësimi i praktikave dhe i politikave regjionale të menaxhimit të ujërave në pellgun e lumit Sitnica dhe atij të lumit Loire, përmes këmbimit të njohurive dhe praktikave të mira.

Ky bashkëpunim synon arritjen e objektivave të kërkuara nga Direktiva Kornizë Evropiane për Ujërat (2000), Ligji francez për Ujërat dhe Mjediset Ujore (2006) dhe Ligji për Ujërat e Kosovës (2013).

Kryetari Bahtiri ka falënderuar për iniciativën e këtij projekti, sidomos kur bëhet fjalë për lumin Sitnica i cili nganjëherë shkakton dëme të mëdha kur ka reshje të mëdha shiu. "Çdo projekt që ka të bëjë me normalizimin e lumit Sitnica do të jetë i mirëseardhur për Komunën e Mitrovicës", është shprehur Bahtiri.

Vlen të theksohet se ky bashkëpunim mundëson aplikimin në partneritet për thirrjet për aplikim në tenderimet evropiane rreth kësaj tematike.

Edhe kryetari i Komunës së Kastriotit, Xhafer Gashi, dhe Joseph Giustiniani, atashe për bashkëpunim pranë Ambasadës Franceze, kanë nënshkruar të enjten një marrëveshje bashkëpunimi për menaxhimin e resurseve ujore, me theks të veçantë të lumit "Sitnica".



# I kujt do të jetë shtatori?



Nga Bedri ISLAMI

Ka disa ditë që shefat e opozitës, të shkuarit e të sotmit, paralajmërojnë se muaji shtator do të jetë ai i rrëzimit të Qeverisë "Rama" dhe se, përmes një revolucioni opozitar, do të shkallmohet bota e mafisë, do të marrë arratinë shefi i tashëm i qeverisë dhe gjithçka do të fillojë nga e para.

Shtatori është vërtet muaji nostalgjik i Berishës. 20 vjet më parë, pikërisht kur Kosova ishte në udhëkryqin e saj më të madh, do të bëhej apo jo shtet i pavarur, "rastësisht" në të njëjtën kohë me ofensivën serbe dhe dezertimet e një grupi farkistësh të Bukoshit, Berisha provoi atë që sot quhet grushti i shtetit i 14 shtatorit.

Dihet tashmë se si nisi gjithçka 20 vjet më parë, si u nisën mitingashët demokratikë dhe republikanë të prirë nga një monarkist, çfarë vodhën, grabitën, shkatërruan; dihet se si mbi tanke dhe makina të blinduara shëtisnin njerëzit e udhëzuar nga Izet Haxhia dhe ky i fundit në besë nga Sali Berisha; është i njohur momenti kur një farë Spahie thërriste në mikrofonin e RTSh-së se "qeveria ra dhe se na jena tash qeveri", ashtu si dihen nga të gjithë zbythjet pas një deklarate ndërkombëtare, tërheqja në bodrumet e selisë së tyre, ku më shumë kishte automatikë dhe mitraloza sesa kishte njerëz.

Nostalgjia është e çuditshme: të bën të ëndërrosh dhe të krijosh në vete sajesën se një ditë shtatori, përmes një grupi, më shumë të paguar sesa idealistë, mund ta rrëzosh Qeverinë, mund ta përmbysësh pushtetin dhe se pastaj, si nga një dorë e heshtur, mund t'i marrësh zyrat e ministrive dhe të vendosësh aty besnikët e tu.

Pamja fantazmagorike dhe turbulluese e disa të rinjve lëseëistë në Jalë, të cilët si një kor naziskin bërtisnin për ta shembur qeverinë dhe për të shkuar pas "burrneshës", e bënin gjithçka edhe më pështiruese, pa folur pastaj për disa fëmijë, ende 10-vjeçar, të cilët, si duket, i kishin marrë seriozisht fjalët e Petrit Vasilit dhe ishin nisur nga dielli i jugut për ta shembur qeverinë.

Ka pesë vjet e diçka më shumë qe Berisha bën të njëjtën thirrje: të shembet qeveria. Ende pa dorëzuar çelësat e zyrës së tij, të cilat i la diku në shtatorin e para pesë vjetëve, ish-shefi i Qeverisë bëri paralajmërimet si Kasandra greke: kjo qeveri do të shembet, këtë qeveri do ta rrëzojmë, të ngrihemi në revolucion, ta shkallmojmë pushtetin e bijve të etërve, duke menduar se gropa financiare që kishte lënë pas vetes nuk do të mbushej kurrë.

Gjithçka është e qartë pse ndodh një thirrje e tillë: tek ai, me gjithë pavendosmërinë e rilindësve socialistë, është ende ndjenja e humbjes e bashkuar me drojën e së ardhmes.

Më mirë se gjithë të tjerët ai e di se kësaj here gjërat mund të shkojnë krejt ndryshe nga sa është pritur dhe se, lufta që i kanë shpallur diplomacisë ndërkombëtare nuk ka të bëjë as me Lu e as Vlahutin, dy nëpunës të zellshëm që përçojnë një vijë të ardhur nga larg; ajo ka të bëjë me mesazhet që përcjellin dhe që, askush tjetër nuk i ka mbi kokë si i ka ai.

A mund të ndodhë një 14 shtator tjetër, si ai para 20 vjetëve?

Berisha, Kryemadhi, Basha, një grup rreth tyre e dinë fare mirë se nuk mund të ndodhë. Detyra ia do t'i japin zemër vetes dhe të përpiqen të largojnë të keqen.

Prej kësaj treshe njeriu që do të mund të përpiqej të bënte diçka seriozisht, nëse do të kishte forcën e duhur, do të ishte Kryemadhi. Ajo, më mirë se kushdo tjetër, e di se, megjithë pispiqiket e Vasilit, LSI po vazhdon të shkërmoqet, ajo ka humbur elektoratin që mbahej përmes vendeve të punës dhe shumë prej tyre janë konvertuar lehtësisht në rozën e së majtës. Prova me të rinjtë e Jalës që kërkonin "burrneshën", është nga ato sforcimi që mund të bëjë njeriu i cili ka dëshirën, por nuk ka forcën. Ajo ka të rinj pas vetes, gjithnjë në rënie, por ka pak mitingashë që janë të gatshëm të përplasen. I mungon goditja, dhe kjo nuk mund të vijë përmes një çizmeje. Prakticizmi i Metës ka rënë në një agresivitet çalamanësh dhe roli primar i Vasilit e zhyt edhe më tej në krizë një forcë politike që për 8 vite luajti "hapa, dollapë" në politikë.

Nëse Kryemadhi do t'i kishte mitingashët e Bashës dhe korpusin Azem Hajdari, atëherë mund të kishim një shtator turbullues.

Basha, mund ta dojë përmbysjen, por më tepër kërkon pjesën e tij. Ai është politikani që së pari të sheh nga duart, çfarë fiton, çfarë merr, çfarë nuk jep. I angazhuar në parti përmes familjes së tij politike, ai e ktheu atë në një fermë familjare, ku roli i kunatit dhe i gruas me njerëzit e saj është mbi parimin.

Basha do të donte të kishte një shtator të zi, por me kushtin që në fund ai të ishte fituesi i një shume miliona eurosh dhe të mos bëhej pis në kostumin e tij të javës.

Për të, si për pak kënd tjetër, më shumë vlen kurdisja e orës së dorës, takëmet e shtrenjta dhe pikturat e çmuara, se sa përplasja në rrugë. Edhe kur ngre zërin e kërcënon, të duket si një xhambaz, që pasi ka parë dhëmbët e kuajve, bën edhe pazarin. Çadra ishte dëshmia e një politikanë që ka fitimin, joshjen, mashtrimin e gënjeshtrën në përparësinë e rrugës së tij sesa një vizion e program politik. Ai do të ishte i gatshëm për një kompromis politik nëse i afrohen ato institucione, të cilat, si në qershorin e shkuar, i afronin pjesë të fitimit.

Berisha është njeriu më i interesuar, jo për partinë që drejtoi dhe e bëri lesheli, por për jetën e tij, familjen dhe të ardhmen. E ka ëndërruar gjithnjë vendin e tij në histori. Ende nuk e di se ku do të jetë: në fillimin e një piedestali apo në kosh. Nëse Vetingu i shkon çështjeve deri në fund, pra, nëse shtrihet edhe tek politika, koshi i duket më afër.

Do ta ketë vështirë të gjejë pasues që lë kokën për të; të varfër që përgjërohen për jetën e tij. Pasuesit po shohin nga foleja Basha, të varfrit shohin se si jeton i biri, i cili vetëm nga qiratë mund të bëjë jetë përrallore dhe nuk do t'ia kenë ngenë një 14 shtatori të dytë.

Jo çdo gjë mund të përsëritet. Rama, si thotë deri në ledhatimin e vetes Berisha, mund të jetë i ndrojtur dhe ka një pjesë të së drejtës, sepse për një shef qeverie kurajoz do të duhej të ishte përgjigjur disa herë para drejtësisë, por gjendja nuk është e njëjtë me atë të 20 vjetëve më parë.

Berisha nuk ka më gardën e tij gjysmë private e gjysmë shtetërore. 20 vjet më parë, njerëzit e tij në gardë dorëzuan mjetet e blinduara dhe u bënë pjesë e grushtit të shtetit. Ai nuk ka më njerëz që të jenë në gjendje ta mbushin Shqupin politik me armatim, të lehtë e të rëndë, megjithëse ajo ka qenë dikur shtëpia e ushtarakëve dhe ia heq dera armën; ai nuk ka më banditët e Bukoshit, të cilët lanë luftën në Kosovë dhe në marrëveshje me qeverinë malazeze e në përcjellje të saj, kaluan kufirin dhe u bënë pjesë e grushtit të shtetit. Mbi të gjitha, ai nuk ka më besimin se do të jetë edhe një herë njeriu i forcës, i mundësisë për të ardhur në pushtet dhe për të bërë shpërblimet si dikur.

Shtatori do të jetë një muaj si gjithë të tjerët. Mund të ketë ende njerëz që besojnë tek një shtresë e pasur politike dhe tek disa figura të shkërmoqura politike si Paloka, Dule… ku vajti ky?, Mediu i Gërdecit, Pollo i fijeve optike, Muli i përmjerjes parlamentare, Ristani që fut duart në kutitë e votimit sikur nxjerr një shishe raki "Skrapari", balli i vockël që kërkon babanë, Alibeaj, që tkurr zërin për ta nxjerrë gjoksin, vogëlushet lësiste që ende nuk kanë marrë diplomën dhe duan politikën e madhe të rrugës, …në fund të fundit njerëzit do të thonë natyrshëm: po ne i kishim këto, i provuam dhe e shikuan se çfarë malli ishin.

Rilindja duhet shkundur, kjo është një e vërtetë e ditur. Si të thuash, është një e fshehtë e hapur. Problemi është se kush do ta lëkundë atë dhe cilët janë të aftë ta shkundin.

Rama mund të ketë droje, por jo nga këto.

Këto ngjajnë me idhullin e tyre, ish-kryeprokurorin Llalla, për të cilin desh dogjën dynjanë dhe i cili, çdo shtator thoshte se këtë herë do ta bëjmë namin.

Pastaj strukej dhe bënte llogaritë e tokave.

Këto, ende pa e pyetur hanxhinë, popullin, bëjnë llogaritë e tyre.

Nuk thonë kot: Llogaritë e shtëpisë nuk dalin në pazar.

## Vazhdojnë nderimet për senatorin McCain

UASHINGTON, 30 GUSHT - Homazhet për senatorin e ndjerë John McCain kanë vazhduar të enjten në shtetin e tij Arizona me një shërbesë përkujtimore në qytetin Feniks. Miku i senatorit McCain, ish-nënpresidenti Joe Biden, ka folur në ceremoni. Sot (e premte) ceremonitë do të zhvendosen në kryeqytetin Uashington, kur trupi i senatorit të vendoset në sallën rrethore të Kapitolit, ndërsa varrimi do të bëhet nesër (e shtunë) në Akademinë e Marinës në Anapolis të Merilendit.
Një numër i madh njerëzish presin në radhë për t'i shprehur nderimet për senatorin. Ata që pritën të mërkurën deri në orët e vona për t'i shprehur nderimet, u befasuan kur familja doli për t'i falënderuar. Pas ceremonisë përkujtimore të së enjtes në Feniks, trupi i McCain do të sillet në Uashington, ku do t'i bëhen nderime të premten në Kapitol, pas një ceremonie tjetër për nder të jetës dhe karrierës së tij.
Ceremonitë vazhdojnë nesër (e shtunë) në Katedralen Kombëtare të Uashingtonit, ku mes të tjerësh do të flasin ish-presidenti Barack Obama dhe George W. Bush.
McCain do të varroset të dielën në Akademinë e Marinës në Anapolis të Merilendit, ku kishte bërë studimet. Ai vdiq të shtunën pas një beteje të gjatë me kancerin në tru.



# Trumpi: ShBA-ja mund t'i rifillojë manovrat me Korenë e Jugut

Presidenti amerikan Donald Trump ka fajësuar Kinën për vështirësitë në marrëdhëniet e ShBA-së me Korenë e Veriut, por ka paralajmëruar se ShBA-ja mund t'i rifillojë në çdo kohë stërvitjet e përbashkëta ushtarake me Korenë e Jugut dhe Japoninë nëse nuk ka përparim në çështjen e çnuklearizimit të Koresë së Veriut

UASHINGTON, 30 GUSHT - Presidenti Donald Trump paralajmëroi se Shtetet e Bashkuara mund t'i rifillojnë në çdo kohë stërvitjet e përbashkëta ushtarake me Korenë e Jugut dhe Japoninë nëse nuk ka përparim në çështjen e çnuklearizimit të Koresë së Veriut. Ai paralajmëroi se ato do të jenë shumë më të mëdha se ndonjëherë më parë.
Presidenti Trump e bëri deklaratën e Shtëpisë së Bardhë të mërkurën në mbrëmje nëpërmjet "Twitter"-it, duke fajësuar Kinën për vështirësitë në marrëdhëniet e ShBA-së me Korenë e Veriut.
Një zëdhënëse e Ministrisë së Jashtme kineze i quajti komentet e presidentit Trump "të papërgjegjshme" dhe konfuze. Ajo tha se ShBA-ja së pari duhet ta shikojë veten përpara se t'ia hedhë fajin të tjerëve për mungesë përparimi me Phenianin.
Presidenti Trump, megjithatë, la të kuptohet se ekziston ende mundësia për përparim diplomatik, duke thënë se ai beson se marrëdhënia e tij me Kim Jong Unin është shumë e mirë dhe e ngrohtë dhe nuk sheh asnjë arsye tani për tani që të shpenzohen para për stërvitjet e përbashkëta me Korenë e Jugut.


AP

Në Samitin e Singaporit në qershor, Trumpi mori vendimin e papritur për t'i pezulluar stërvitjet e përbashkëta pasi Kim Jong Uni bëri një premtim të gjerë për të punuar drejt çnuklearizimit të plotë të Gadishullit Korean.
Komentet e presidentit Trump vijnë një ditë pasi sekretari i Mbrojtjes, Jim Mattis, tha se Pentagoni po shqyrton rifillimin e stërvitjeve të përbashkëta ushtarake me Korenë e Jugut vitin e ardhshëm. Mattisi tha në një konferencë me gazetarë në Pentagon se pezullimi i stërvitjeve këtë verë ishte një gjest mirëbesimi ndaj Koresë së Veriut, por se ky nuk është një angazhim që mund të vazhdojë pa fund.

# Macron: Është koha për realizëm në marrëdhëniet BE - Rusi



HELSINKI, 30 GUSHT - Presidenti francez Emmanuel Macron i ka bërë thirrje Bashkimit Evropian të enjten t'i modernizojë lidhjet me Rusinë, pas Luftës së Ftohtë dhe të krijojë "marrëdhënie strategjike" me Turqinë dhe vendet e tjera fqinje, duke përfshirë çështjet e mbrojtjes.
Macroni mbron fuqishëm aftësinë e Evropës për t'i mbrojtur interesat strategjike dhe të sigurojë pavarësi financiare, në përgjigje të situatës së re globale në aspektin ekonomik dhe atë të mbrojtjes, të sjellë nga udhëheqja e presidentit amerikan Donald Trump, transmeton "Reuters".
Lideri francez ka thënë se Evropa është varur për kohë të gjatë në mbrojtjen amerikane dhe se, ndonëse mbrojtja e NATO-s vazhdon të jetë e rëndësishme, BE-ja duhet të bazohet në kapacitetet e veta për mbrojtje. "Është në interesin tonë që BE-ja të ketë marrëveshje strategjike me Turqinë dhe Rusinë, të cilat për periudhë afatgjatë ofrojnë më shumë fuqi dhe koherencë", ka thënë ai në një konferencë me gazetarë në Helsinki.
Prej majit të vitit të kaluar kur ka fituar presidencën, Macron ka tentuar t'i përmirësojë marrëdhëniet me presidentin rus Vladimir Putin. Këto përpjekje janë komplikuar pas aneksimit të Krimesë nga Ukraina më 2014, rolin e saj në konfliktin në lindje të Ukrainës, mbështetjen për presidentin sirian Bashar al-Assad dhe supozimet për ndërhyrje ruse në zgjedhjet e huaja.

## Agjencia e OKB-së raporton se Irani po zbaton paktin bërthamor

NJU JORK, 30 GUSHT - Irani ka zbatuar plotësisht marrëveshjen bërthamore të vitit 2015 që ka nënshkruar me fuqitë botërore, pavarësisht prej tërheqjes së Shteteve të Bashkuara nga ky pakt, ka thënë një vëzhgues bërthamor i Kombeve të Bashkuara.
Raporti i Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Atomike, të publikuar më 30 gusht, është shkresa e dytë prej kur presidenti amerikan Donald Trump ka njoftuar në muajin maj për tërheqjen e Uashingtonit nga pakti dhe për rivendosjen e sanksioneve kundër Iranit.
Në raportin e fundit Agjencia ka thënë se inspektorët e saj kanë pasur qasje "në të gjitha zonat dhe lokacionet në Iran", ashtu siç është e paraparë në marrëveshje.
Mirëpo në të gjetura është thënë se Teherani mund të bëjë më shumë për të bashkëpunuar me inspektorët ashtu që "të rritet besimi".
Teksa kishte njoftuar për tërheqje nga kjo marrëveshje, Trumpi pati thënë se kushtet nuk janë mjaftueshëm të ashpra për ta parandaluar Iranin që të zhvillojë armë bërthamore dhe ka akuzuar Teheranin për shkelje të "shpirtit" të marrëveshjes, duke financuar militantët islamikë në rajon.
Irani kundërshton mbështetjen për kryengritësit derisa ka deklaruar se programin



bërthamor e ka vetëm për qëllime të energjisë.


PROMOVIM
Mr. sci. Hamz S. Lladrovci
ÇËSHTJA SHQIPTARE
PËRBALL DIPLOMACISË DHE
GJEOPOLITIKËS RUSO-MADHE
1856-2018
Prishtinë 2018
ÇËSHTJA SHQIPTARE PËRBALL DIPLOMACISË DHE
GJEOPOLITIKËS RUSO-MADHE 1856-2018
Mr. sci. Hamz S. Lladrovci
Promovimi i librit mbahet më:
01.09.2018 (e shtunë)
në orën 12:00 në
Hotel Grand në Prishtinë, (Salla solemne)

E jashtëzakonshme

# Fshati që po përpiqet t'i ndalojë të gjitha macet



Një fshat i vogël në bregun jugor të Zelandës së Re po planifikon ta zbatojë një plan radikal për t'i mbrojtur kafshët e egra të natyrës, por duke ndaluar të gjitha macet. Sipas iniciativës së propozuar nga ambientalistët e tokës, pronarët e maceve në Omaui do të duhet të pajisen me mikroçip dhe regjistrojnë macet. Pasi kafsha e tyre të ngordhë, të apasionuarit pas maceve në komunitet nuk do të lejohen të marrin më.

FOTO E DITES




Tifozët e ish-mbretit të popit, Michael Jacksonit, shihen duke festuar ditëlindjen e tij para statujës në Londër. /AP/

E rrallë

# Bletët "pushtojnë" të famshmin "Times Square"

Mijëra bletë "pushtuan" pjesë të "Times Square" duke krijuar panik te turistët dhe kalimtarët. Bletët u vendosën më pas në kioskën e një shitësi në "43 Street and Broadway". Masa e insekteve ishte aq e dendur sa ulte nga pesha pjesë të çadrës së shitësit që shërbente "hot dog".



Incidenti zgjati rreth një orë para se ekipi i posaçëm i Departamentit të Policisë së Nju Jorkut t'i merrte bletët dhe t'i dërgonte diku tjetër.

## BARSOLETA E DITËS



**E pyet djali të ëmën:**
**- Nënë, si janë krijuar njerëzit?**
**- Zoti na ka krijuar…**
**- Po babi më ka thënë se e kemi prejardhjen prej majmunit?**
**- Bir, unë po të flas për të mitë, babai të ka folur për të vetët!**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Vetem gjate vikendit në ora 16:00**

### " INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird




**Në ora 18:20**

### "FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco




**Në ora 20:00**

### "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed







**Në ora 22:00**

### "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Kritikat e bëra ndaj jush po japin rezultate pozitive në punën tuaj sepse keni marrë me të mirën prej tyre dhe e keni vënë në zbatim.



**DEMI**
Keni kuptuar që jeta është e përbërë edhe nga gjëra të tjera përveç punës dhe po u dedikoheni këtyre gjërave tërësisht sot.



**BINJAKËT**
Iniciativat që do të ndërmerrni sot do t'ju japin shumë zgjidhje personave afër jush. Dikush do t'ju shpreh falënderimet në një mënyrë të ngrohtë.



**GAFORRJA**
Një problem konstant që nuk po ju lë të avanconi duhet ta zgjidhni nga rrënjët sepse do të vazhdojë t'ju torturojë për një kohë të gjatë.



**LUANI**
Sot keni vënë në dukje një anë të panjohur tuajën dhe mjaft të ndjeshme. Jeni kokëfortë në shumicën e rasteve dhe nuk i tregoni ndjenjat tuaja.



**VIRGJERESHA**
Dikush do të kërkojë sqarime nga ju se përse gjatë kësaj kohe nuk keni shfaqur përkushtimin e duhur. Është diçka momentale që do të sqarohet.



**PESHORJA**
Këtë periudhë keni zgjedhur një mënyrë kontradiktore për të qenë në vëmendje, vetëm nëpërmjet heshtjes tuaj dhe injorimit të personave të caktuar.



**AKREPI**
Keni bërë ç'është e mundur për të sqaruar gjërat me një person të caktuar, por përsëri ju kanë keqkuptuar.



**SHIGJETARI**
Sot mund t'ju lindin probleme me familjarët sepse nga punët e tepërta do të harroni disa ngjarje dhe situata që nuk mund të harrohen.



**BRICJAPI**
U keni dhënë hapësirën e duhur personave të duhur, por nuk jeni shprehur për këtë gjë. Do të keni mirënjohjen e tyre në të ardhmen e afërt.



**UJORI**
Të ecni përpara në karrierën tuaj në këto momente paraqitet mjaft e vështirë. Ka rrethana të caktuara që nuk ju lejojnë të bëni atë që doni.



**PESHQIT**
Sot doni të ndryshoni rrugën që keni marrë për të tejkaluar një problem të caktuar. Duhet të merrni dhe mendimin e të tjerëve.

# Meek Mill dhuron 6 mijë çanta për fëmijët e qytetit të tij



Me ardhjen e vitit të ri shkollor, Meek Mill pati një befasi. Sipas një njoftimi të fundit, reperi ka dhuruar mbi 6 000 çanta për studentët në qytetin e vet të lindjes, Filadelfia. "Duke u rritur në Filadelfia, unë kam parë familje që luftojnë për të mbijetuar dhe për të blerë gjëra për shkollë për fëmijët e tyre. Këto kujtime mbeten me mua, prandaj doja ta bëja këtë gjë në qytetin tim, për t'u dhënë buzëqeshje fytyrës së fëmijëve dhe për t'i ndihmuar ata ta fillojnë vitin e ri shkollor me të gjitha pajisjet", ka thënë Meek.



# Georgina magjeps Venecian

Shumë yje, të veshur me markat më të mira, parakaluan në tapetin e kuq në edicionin e 75-të të Festivalit të Filmit në Venecia. Mes të ftuarve ishte edhe gruaja e Cristiano Ronaldos, Georgina Rodriguez, e cila kishte preferuar një fustan transparent, që i rrinte i ngjeshur pas trupit. Bukuroshja spanjolle tërhoqi vëmendjen me format e saj vërtet joshëse, ndërsa fotografët nuk e humbën mundësinë të fiksojnë imazhe gjatë parakalimit të saj.

# Leonardo DiCaprio afër fejesës me Camila Morrone



Leonardo DiCaprio mund t'i thotë së shpejti lamtumirë jetës së beqarit! Duket se pas lidhjes tetëmujore me të dashurën e tij 21-vjeçare Camila Morrone, aktori është gati për një hap më serioz në romancën e tyre. "Ata janë shumë të dashuruar dhe kanë qëllime serioze për lidhjen e tyre. Ata kanë folur dhe kanë plane reale për fejesë", ka thënë një burim i afërt me çiftin për revistën "US Weekly". Pavarësisht se e dashura e tij është 22 vjet më e re se DiCaprio, ky burim ka thënë se ylli hollivudian 43-vjeçar kurrë "nuk ka qenë më i dashuruar".

# Jamie Foxx viziton fshehurazi Katie Holmes në Nju Jork

Jamie Foxx dhe Katie Holmes akoma po vazhdojnë pushimet e tyre të verës. Aktori së fundmi është parë duke e vizituar të dashurën e tij në qytetin e Nju Jorkut. 50-vjeçari Foxx kishte veshur një palë xhinse të shqyera dhe një bluzë të zezë derisa shihej duke mbajtur dy çanta. E dashura e tij, aktorja 39-vjeçare, kishte veshur një palë xhinse, bluzë të kuqe dhe sandale.





Në shenjë të 50-vjetorit të demonstratave të vitit 1968

# DITARI I PROFESO

Shkruan: Ismail SYLA

**- Dy mësimdhënës të mi në Gjimnazin "Skënderbeu" të Gllogovcit**

Nobelisti Elias Canetti në librin e vet autobiografik "Gjuha e shpëtuar" (historia e një rinie), të gjithë profesorëve që i dhanë mësim në gjimnazin e Cyrihut ua bënë portretin me një dashuri të veçantë. Në librin e tij kuptojmë se sa e rreptë dhe serioze ka qenë mësimdhënia në shkollat zvicerane në periudhën mes dy luftërave botërore. Për profesorin e historisë, i cili ua shpjegonte me rrënjë historinë si ngjarje, si fakte, por edhe rolin e personaliteteve në historinë e njerëzimit, tregon se kishte momente që i rrëqethej jo vetëm lëkura e fytyrës, por i kreshpëroheshin edhe flokët.

Duke kujtuar këtë detaj të "Gjuhës së shpëtuar", më erdhi ndërmend viti shkollor 1975/76 i klasës së parë në Gjimnazin "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu". Në Gllogovcin e atëhershëm gjimnazi ende punonte në barakat mes stacionit të autobusëve dhe ndërtesës së shkollës fillore. Paralelet e klasave të para dhe të katërta zhvillonin mësimin pasdite. Kujdestari im, i klasës së parë (dy), qëlloi të jetë profesori i historisë, Sahit Berisha. Me një fytyrë paksa zeshkane, flokë pjesërisht të gjata, i veshur me komplete rrobash dhe këmishë elegante, profesori Sahit shquhej me trupin e drejtë, të ngrehur, shenjë e pedanterisë dhe një krenarie të lindur. Me këpucë elegante të modës, me maja të mprehta dhe taka të larta, ai e maskonte disi trupin e shkurtër. Por, gjykuar me sytë e asaj moshe, profesori atëherë 28-vjeçar, që jetonte në Prishtinë, ishte gjithsesi i madh dhe serioz.

Orët e historisë ato pasdite vjeshte ishin nga më interesantet, sepse nga sytë e profesorit rrezatonte dëshira për të na shpjeguar historinë jo vetëm si planprogram i klasës së parë të gjimnazit, që ishte fillimisht i paorientuar. Kish një dallim cilësor dhe intensiv midis mësuesve të fillores dhe disa prej profesorëve të gjimnazit, që për lëndët përkatëse ishin më të kualifikuar. Një ngjyresë të veçantë shpjegimi dhe komunikimi profesori Sahit e bënte sidomos tek pjesa e historisë së popullit shqiptar. Historia antike kulmonte me historinë e ilirëve. Fiset, luftërat, mbretëria ilire, luftërat ilire - romake, autoktonia e shqiptarëve etj. E kulmi i entuziazmit arsimdashës dhe frymës atdhetare të kohës, dilte në sipërfaqe në rast vizite të ndonjë prindi, të cilin profesori e sillte në klasë, dhe e ulte në karrigen e tij, te tavolina e punës. Atëherë jashtë programit profesori bënte "përsëritje mësimi" dhe ne nxënësit bënim garë se kush po përgjigjet më shpejt në pyetjet lidhur me historinë ilire. Duhet theksuar edhe një fakt të vërtetuar, klasa ime kishte shumë nxënës të zgjuar. E kështu, profesori krenohej me nxënësit e vet, po edhe prindi i rastit sigurisht se ndahej i kënaqur.

Koha rridhte. Drejtimi shkencave natyrore nuk kishte lëndë historie në vitin e dytë. Në të tretin dhe të katërtin na dha histori një profesor tjetër. Por, me profesorin Sahit nuk i shkëputëm lidhjet. Disave prej nesh, si nxënës të pasionuar në lexim, profesori na sillte ndonjë libër të ndjeshëm, të botuar në Tiranë. Që atëherë e kuptuam edhe shprehjen shqiptare për standardin e prodhimeve. Kish prodhime JUS (jugosllovenski standard) DIN (prodhime gjermane) etj., por kish edhe STASH (standard shqiptar). Në fund të librave të botuara në Tiranë nga "Mihal Duri" ose "Naim Frashëri" dimensionet e formatit të librit jepeshin me masën e centimetrave, sipas Stash (standardit shqiptar). Këmbimi i librave të ndaluar midis profesorëve dhe nxënësve ishte një shkallë e lartë besimi dhe një luks i jashtëzakonshëm në kohën kur "lulëzimi" autonomist i Kosovës e kishte verbuar shumëkënd dhe syri policor i sigurimit shtetëror rrinte zgjuar, së bashku me disa struktura të verbra ideopolitikisht, që Josip Broz Titon "Plakun" e kishin në zemër. Në atë kohë kisha rezervuar të pashtershëm librash të ndaluar në saje të organizimit në GML (Grupi Marksist Leninist i Kosovës). Me profesorin kam këmbyer çdo gjë. Asnjëherë nuk dështoi asgjë midis nesh. As pas burgosjes sime. Profesori Sahit Berisha ishte pjesë e simpatizantëve të Grupit Marksist Leninist të Kosovës, i pajisur vazhdimisht me materialet e grupit, të cilat i fotokopjonte dhe i shpërndante tek simpatizantë të rrethit të tij.




## ...Viti 1981 bëri kthesë... Pastaj kaloi një dekadë...

Pas rënies së kontrollit komunist të arsimit, në tetorin e viti 1990 në gjimnazin me emër të rikthyer "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu" (prej vitit 1979 Skënderbeun e zëvendësoi Mareshali Tito), së bashku me profesorin Sahit Berisha më ra fati të jem mësimdhënës. Aty ku kisha kryer klasën e dytë, të tretën dhe të katërtën tash po punoja si profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe. E kisha të qartë qëmoti se kush kishte qenë familja Berisha, kush ishte Rifat Berisha, vëllezërit dhe kushërinjtë e tij, që kishin rezistuar kundër forcave serbe të OZNA-s më 1949, duke treguar mospajtimin me robërinë e re komuniste të Kosovës. E kisha të qartë edhe diskriminimin që kishte përjetuar familjet Berisha, me kontrollet e vazhdueshme të UDB-së në çdo kohë të ditës, natën dhe pas mesit të natës, fatin e të arratisurve në Shqipëri, fatin e disa prej tyre që kishin braktisur fshatin Berishë për t'u vendosur në qendra urbane, sadopak për t'i ikur terrorizimit të përditshëm. Ndërsa, prej vitit 1990 shprehej hapur simpatia për Berishët e anatemuar dhe gjithë patriotët e ndaluar me dekada të tëra, si Shaban Polluzha Mehmet Gradica etj. Disa varreza u rregulluan në Berishë

Përpos profesorit Sahit, gjatë tri viteve gjimnaz pata fatin ta kem profesor të gjuhës Rasim Berishën, një veteran tipik i arsimit, një patriot i heshtur dhe stoik që kurrë nuk u lakua, ndonëse i shpëtoi prangave të burgut. Për profesorin Rasim, gjegjësisht për vështirësitë e shkollimit të tij më fliste babai im, ndërkaq në raste të rralla vetë profesori na fliste për kushtet e rënda të banimit në Prishtinë, si nxënës i shkollës së mesme dhe student, veçanërisht gjatë dimrit, për bukën e misrit që e merrte me vete nga shtëpia, me të cilën ushqehej një javë, për rrugën e përshkuar këmbë prej fshatit Berishë deri në Prishtinë dhe anasjelltas. Edhe profesori Rasim me kënaqësinë më të madhe i merrte librat e ndaluar, i lexonte dhe asnjëherë nuk ekspozohej. Ishte dhe është akoma det i thellë, por i qetë, i matur, pa nguti, tërë jetën pa turr e pa vrap. Ai në heshtje kishte simpati për nxënësit e familjeve me orientin atntijugosllav. Për dallim nga profesori Sahit, Rasim Berisha shquhej për konstruktin trupor të banorëve të bjeshkës, ishte trupmadh, me sy ngjyrë qielli të thellë, oratori ngadalshëm, por që fjalët t'i ngulit si gozhdët që i ngulit një çekan i rëndë. Ai shquhej për një sërë anekdotash që jetojnë ende. Më spirituozja ishte ajo që lidhej me shkollimin e policëve të mbetur prapa në shkollim të mesëm. Dhe kur njëri prej tyre e pyet profesorin Rasim se "çka kemi ba?", duke nënkuptuar provimin me shkrim, profesori i përgjigjet me nëntekst: "E po çka nuk keni lanë pa ba!", si një qëndrim përbuzës, rezistencë dhe rezervë ndaj këtij segmenti të pushtetit jugosllav.

## Normalja e Prishtinës

2018-a është një vit që rrumbullakon në mënyrë jubilare përvjetorin e 550 të vdekjes së krye heroit shqiptar Gjergj Kastrioti, 110-vjetorin e Kongresit të Manastirit, 50 vjetorin e demonstratave të 1968-s, 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës. Se do ta bëja një shkrim për demonstratat e vitit 1968 në këtë vit jubilar vetvetes ia kisha vë detyrë, por disi nuk e gjeja fillin. Këto ngjarje me rëndësi epokale u zhvilluan kur unë isha veçse shtatë vjeç. Nga tërë kujtesa e asaj kohe, pa radio, pa gazeta pa televizor, e madje pa rrymë elektrike, më kujtohet që flitej se në Prishtinë

# RIT



njerëzit kishin thyer xhama të shitoreve, të autobusëve dhe të veturave. Që të jem i sinqertë, asnjë përfytyrim dhe asnjë ide për parulla ose kërkesa politike nuk më kujtohen. Ndërkaq, për veprimet politike prej vitit 1971 e këtej, fatbardhësisht i kam përjetimet, përfytyrimet dhe kujtesë time konkrete individuale.

Qesh me fat dhe u motivova edhe më shumë për shkrimin peng të vetë-premtuar, kur para disa ditësh profesori im, ish kujdestari i klasës Sahit Berisha, ma dha për lexim tekstin e tij të titulluar "Shkolla Normale dhe Demonstratat e vitit 1968" (Kujtime e njohuri të gërshetuara) me 36.070 fjalë. Një libër i ardhshëm, në të cilin ai e shkrin dashurinë për shkollën, e cila u bë institucion i përgatitjeve të arsimtarëve të shkollave fillore anembanë Kosovës, por edhe i kuadrove të profileve nga më të ndryshme.

Në kujtimet e tij profesori Sahit Berisha përshkruan gjerësisht platformën pedagogjike të Normales, objektivat mësimore dhe synimin për të përgatitur kuadro për mësimdhënie në shkollat fillore. Përtej natyrës akademike të ndërtimit të tekstit, ditari i profesorit të historisë është interesant veçanërisht në pjesën ku ai përshkruan konkretisht momentet jetësore të lidhura me Shkollën Normale. Do të thotë pjesa e rrëfimit individual, të cilit i rri besnik, duke mos mbitheksuar rolin e vetvetes. Përkundrazi, Sahit Berisha në këto kujtime shquhet për sensin dhe virtytin që gjendet rrallë tek autorët e biografive personale, qëndrimi modest ndaj vetvetes dhe dhënia e kredive reale të tjerëve. Si njeri i moshës rinore, ai me dashuri dhe nota optimiste përshkruan pikën gjeografike ku ishte objekti shkollor, siç thotë ai, në formë të germës L. Por, me nota tjera, realiste, i përshkruan vitet e Normales, kur drejtori ishte serb, e që përpos urrejtjes e kishte mision edhe nxitjen e përçarjes midis profesorëve dhe nxënësve shqiptarë: "Ai udhëhiqte gjithmonë me urdhra të prera, të paargumentuara, ka përkrahur gjithnjë një grup të privilegjuar, ku është mundësuar ndasia dhe përçarja e kolektivit të arsimtarëve dhe nxënësve." (f. 31). Autori, po ashtu flet për rolin emancipues të Normales, kur nxënësit kishin nevojë për të "fituar njohuri për sjelljen dhe pastërtinë" (f. 44). Ndërkaq, nga aktivitet më të rëndësishme jashtë mësimore janë ato të grupit dramatik dhe letrar (me emrin "Migjeni"). Me konsideratë të veçantë, me emër dhe mbiemër i përmend profesorët e respektuar, duke ua dhënë meritat secilit prej tyre si: Fehmi Pushkollit, Demusha Shalës, Rexhep Hoxhës, Ditar Qamilit, Sylejman Carës, Engjëll Berishës (art figurativ), ose Faik Kabës për aktivitete politeknike, pastaj të tjerë vepër sport, fotografi, muzikë etj.

Autori flet edhe për një mënyrë specifike të largimit të shenjave jugosllave nga korridoret e shkollës, një lloj albanizimi i tyre, duke i ndërruar fotot e figurave jugosllave me ato të shkrimtarëve shqiptarë, që bëhej nga nxënës të ndërgjegjshëm politikisht dhe kombëtarisht, e që ishin pjesëtarë të organizatës antijugosllave "Lidhja e Rinisë së Bashkuar" e themeluar nga Adem Demaçi. Nxënësit e Normales, ashtu si dhe të shkollave të tjera, që në moshë të re provonin hijen e sigurimit shtetëror. Pas rënies së Rankoviqit, një ndër udhëheqësit më të lartë serbë që u shqua për urrejtje ekstreme kundër shqiptarëve, nga arkivi i Normales u zbulua "lista e zezë" me emrat e 14 nxënësve dhe profesorëve (f. 65), që përcilleshin nga UDB-a dhe mund të arrestoheshin çdo moment. Sipas disa shembujve të sjellë në shënime, një tregues i presionit të vazhdueshëm mbi nxënësit shqiptarë të familjeve atdhetare ishte edhe kontrollimi i çantave (f. 67) për të gjetur libra të ndaluara, ose dhe për të vënë aty materiale, përmes të cilave do krijonin shkas për t'i burgosur ose larguar nga shkolla. Autori shkruan edhe për qëndrimin politik negativ të Fadil Hoxhës dhe Stanoje Aksiqit, kur nxënësit e Normales, gjeneratat para tij, shkruajnë parullën në rrugën e asfaltuar, në vitin 1963 "Kosova i takon Shqipërisë" (f. 68). Periudha pas Plenumit të Brioneve (Rënia e Rankoviqit, 1966) dhe ndërrimi i drejtorit serb Stanoje Stojanoviq është moment kthese në Shkollën Normale, ku fillon edhe shpalosja e "deformimeve" do të thotë demaskimi i disa prej veprimeve të shërbimit sekret UDB-së, që për një periudhë të gjatë kohore kishte vepruar me dorë të hekurt kundër elementit patriotik shqiptar.

### Krijohet klima për demonstratë

Autori i kujtimeve me të drejtë vë theksin tek tendenca e frymës jugosllave të politikës arsimore. Kjo frymë shtrihej dhe dominonte në tekstet e historisë dhe në kulturë, eambalazhuar me petkun ideologjik të vëllazërim bashkimit socialist jugosllav. Por, sado e ndrydhur, e shtypur dhe e luftuar fryma kombëtare shqiptare, ajo nuk u shua asnjëherë. E, pas Plenumit të Brioneve nis të merr frymëpaksa ma lirshëm. Fotoja e Skënderbeut dhe e flamuri kombëtar kuqezi janë dy shenjat themelore përmes të cilave ekspozohen vetëdija dhe ndjenja kombëtare. Sjellja e një flamuri në klasë ishte një vepër e madhe atdhetare në atë kohë. Ishte veprim historik, bie fjala, kur në vitin 1968 në klasën e parë/katër nxënësi Sali Kastrati ekspozoi haptas foton e Skënderbeut, ndërsa nxënësi tjetër Shaip Gashi pranë fotos vuri një flamur kuqezi (f. 78). Ose kur nxënësi i klasës së katër /një, Gani Krasniqi sjell flamurin, e autori i ditarit, Sahit Berisha (f. 80) e shpalos duke e vendosur në dërrasë të zezë. Edhe pse çohet pluhur nga strukturat politike dhe të sigurimit shtetëror, profesorët kujdestar këmbëngulin që nxënësit të mos pësojnë, si rasti i profesorit Zeqir Bajrami: "Pasi dëgjoi me vëmendje, kujdestari tha: - Askush nuk do të pësojë as me të voglin dënim. Këtë çështje e rregulloj unë. Ju duhet të mësoni. Flamuri është yni. Gani merre flamurin dhe çoje në shtëpi! Derisa në klasë vazhdonte të mbante fjalën profesori i nderuar në korridor nxënësit e klasave të tjera këndonin këngë dhe solidarizoheshin me ne" (f. 80).

Për autorin e kujtimeve një element tjetër për forcimin e vetëdijes kombëtare në Kosovë, përpos shënimit të 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, rol shtytës pat edhe Konsulta Gjuhësore, si një fazë përgatitore për krijimin e gjuhës së sotme letrare, që u kurorëzua me Kongresin e Drejtshkrimit, më 1972. Demonstratat e vitit 1968 në Evropë, ndonëse me karakter tjetër, debati publik në Kosovë për amendamentet kushtetuese, ku u fol hapur për ngritjen e Kosovës në rang republike (f. 81) por që u mbyt shpejt si zë dhe kërkesë nga establishmenti projugosllav, ishin shtytje për daljen hapur të njerëzve përmes demonstrimit publik të kërkesave. Kështu, në Prizren, më 6 tetor 1968 u organizua demonstratë me kërkesë të qartë për Kosovën Republikë. Me 8 tetor u demonstrua në Suharekë (f. 81), më 19 tetor në Pejë duke prirë me flamur kombëtar. Këto ishin demonstratat e para në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore. Ndërkaq, më 27 nëntor demonstrata të fuqishme u organizuan në Podujevë, Ferizaj, Gjilan dhe Prishtinë.

### Demonstrata e Prishtinës, 27 nëntor 1968

"Në vjeshtën e vitit 1968 nxënësit e Shkollës Normale në Prishtinë, më se 1.700 nxënës, ishin të organizuar mirë. Ata ishin të informuar mirë për organizimin e demonstratave në Kosovë. Në këtë shkollë, si në çdo shkollë tjetër në Kosovë, ishin formuar grupet organizative, të cilët bënin përgatitjet për organizimin sa më të mirë të demonstratave. Çështja e parë që duhej bërë ishte ajo e informimit. Informimi dhe shpjegimi i organizimit të demonstratave bëhej në fshehtësi të thellë. Këtë rol e kreu grupi i nxënësve të kësaj shkolle në përbërje Ibrahim Gashi, Remzije Shala, Sahit Berisha, Shemsi Hoxha, Haki Berisha e Sylejman Kastrati. Nuk kishte klasë që nuk ishte informuar dhe në të cilën nuk ishte dalluar ndonjë nga nxënësit që do të përhapte informatat", - shkruan profesori Sahit Berisha në kujtimet e tij (f. 82), duke përmendur disa emra. Mbase kjo është kuintesenca e librit të ardhshëm të kujtimeve të tij. Një rrëfim autentik, për të cilin unë si një brez më i vonë kam pasur nevojë ta di nga dora e parë e një njeriu të brendshëm të 1968-s.

Prej faqes 82 deri në 112 autori flet për fillimin dhe zhvillimin e demonstratës së 27 nëntorit. I tërë rrëfimi është si një film i gjallë, vizual. Të kthen në hapësirë dhe kohë. Autori me përpikëri shpjegon dy pikat (punktet) ku do të tuboheshin demonstruesit, tek Fakulteti Filologjik dhe tek Qendra e Pionierëve, për koordinimin që ndërrimi i pasdites së Normales të arrijë në qendër të qytetit nga shkolla, në mënyrë të organizuar etj. "Mbretëronte një qetësi e pazakonshme ndër nxënës, bisedohej me tone të ulëta dhe me kujdes. Fitohej përshtypja se Prishtina është qetësuar dhe se në qytet kurrë nuk do të organizohen manifestime publike" (f. 83). Të gjitha përgatitjet ishin bërë, por "Vetëbesimi, frika dhe aftësia do të vihen në sprovë në orën gjashtëmbëdhjetë" (f. 85), pra në orën e fillimit të demonstratës.

Paraprakisht autori tregon se një frymëzues i tij ishte një veprimtar i shquar, Halil Alidemaj, i cili kishte njohuri politike dhe ishte në dijeni se po organizoheshin demonstratat. Autori tregon për udhëtimin e tij tek të afërmit e tij në Ferizaj, të cilët, edhe pse të punësuar, arrijnë në Prishtinë më 27 nëntor. Profesori Sahit Berisha shkruan: "Më 27. XI. 1968 në Shkollën Normale erdhën afishet. Unë i shpërndava në klasën time dhe në një klasë tjetër, kur në orë të mësimit ishte profesori i muzikës, Mit'hat Sahiti. Ishte atmosferë e gjallë, tollovi e madhe, pritej të niseshim për në qytet. Në fytyrat e nxënësve shihej një gëzim, por edhe brengosje e shqetësim, pasi për këtë brez ishte e para demonstratë. Kështu duke i shpërndarë afishet vepruan edhe të tjerët. Pas orës së dytë të gjithë u nisëm për në qytet. Unë u shoqërova me grupin e sportistëve për të arritur në Gjimnazin "Ivo Llola Ribar" (f. 88). Nga ky çast e tutje çdo hap përpara ishte një histori e pa përshkuar më parë. Tek normalisti shfaqet droja se a do të jetë masive pjesëmarrja në demonstratë: "Isha i bindur se do të kemi sukses të madh nëse arrijmë të nxjerrim në rrugë numër të mjaftueshëm nxënësish", thotë ai. Demonstrata fillon me kohë. Nxirren pankartat. Marshohet nga Filozofiku drejt qendrës, tek Teatri. Brohoriten parullat: "Bashkohuni me ne", "Universitet", "Kushtetutë", "Barazi", "Republikë" etj" (f. 91). Kërkesat i lexojnë publikisht Osman Dumoshi dhe Skender Kastrati. Nga ana tjetër, edhe nxënësit e ndërrimit të dytë, të pasdites, ishin nisur për në qendër të qytetit. Autori përshkruan grupin e vajzave shqiptare konviktore, të cilat nuk arrijnë të bashkohen me kolonat e demonstruesve, e të cilat rrezikohen nga grupe agresive serbe (f. 94).

Pas dy orësh demonstrim, në orën 18 policia fillon intervenimin mbi demonstruesit në qendër të Prishtinës, afër godinës qeveritare. Përdoren cisternat me ujë. Policia bllokon rrugët kryesore. Përleshja me ta është e pashmangshme vjen një moment që autori e definon bukur "Aty bënte punë guximi dhe gurët" (f. 96). Demonstruesi Gani Krasniqi përpiqet ta rrëmbejë një cisternë, Nexhat Krasniqi ia vë gjoksin topave të ujit (f. 96). "Prej udhëkryqit te "Afërdita", e deri te hoteli "Union", në të dy anët e rrugës, pamë shenja e gjurmë të rrënimit e shkatërrimit, dritare të thyera, gjësende të shpërndara në rrugë, mjete teknike e automjete të rrotulluara. Në rrugë kishte gurë e tjegulla. Nëpër muret e shtëpive vëreheshin gjurmë të llojllojshme e në tokë shiheshin gjurmët e gjakut. Demonstruesit mbizotëruan situatën. Me gjithë mekanizmin e tyre të rëndë forcat policore u tërhoqën. E tërë rruga kryesore e qytetit, e cila fillonte nga Këshilli Krahinor e zgjaste deri te Fakulteti Filozofik, ishte zonë e lirë dhe e mbikëqyrur nga demonstruesit. Shqiptarët për disa orë, kthyen Prishtinën sërish në duart e veta. Policët hipën në automobilat e tyre dhe u nisën në bazë". Kjo ishte gjendja në Prishtinë në një moment të 27 nëntorit 1968.

**(Vijon)**




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

| | |
|---|---|
| BIRMINGHAM - QUEENS PARK | 1 |
| ABERDEEN - KILMARNOCK | 1 |
| ARMINIA BIELEFE - REGENSBURG | 1 |

# UEFA licencon stadiumin 'Fadil Vokrri', Kosova debuton më 10 shtator

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll do të debutojë në Ligën e Kombeve më 10 shtator në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Ishe UEFA ajo që mori vendim të enjten për licencimin e këtij stadiumi, kurse ministri Kujtim Gashi e ka vlerësuar si një moment historik për futbollin e Kosovës. "Më 10 shtator Kosova do të shënojë një akt historik sepse për herë të parë luan në një stadium të pranuar ndërkombëtarisht në territorin e vet", ka thënë ministri Gashi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

